Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Çështje Evropiane dhe të Sigurisë – 33

ÇËSHTJE EVROPIANE DHE TË SIGURISË

Security Issues

Revistë tremujore për sigurinë

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Nr. 33, tetor 2016

Ky numër u përgatit nga:

Besjana Kuçi

Romario Shehu

Ky numër reviste botohet me mbështetjen financiare të

Divizionit të Diplomacisë Publike të NATO-s.

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE **6**

PSE NATO DO TË VAZHDOJË T'U REZISTOJË DHE MBIJETOJË SFIDAVE BASHKËKOHORE GLOBALE? **7**
REDION QIRJAZI

SFIDAT URGJENTE: TERRORIZMI, SIGURIA KIBERNETIKE, PROPAGANDA **35**
GRETA TUČKUTĖ, DEIVIDAS ŠLEKYS

NATO DHE SIGURIA E ENERGJISË: ARRITJET AKTUALE DHE SFIDAT E ARDHSHME **53**
SORIN DUCARU

SAMITI I NATO-S NË VARSHAVË: SI TË FORCOJMË KOHEZIONIN E ALEANCËS? **68**
ALEXANDER MATTELAER

A ËSHTË NATO GATI TË NDËRMARRË NJË HAP VENDIMTAR NË DREJTIM TË MBROJTJES KIBERNETIKE? **106**
MATTHIJS VEENENDAAL; KADRI KASKA; PASCAL BRANGETTO

ENGLISH ABSTRACTS **121**

PARATHËNIE

Revista për Çështjet Evropiane dhe të Sigurisë është një botim që synon të kontribuojë në informimin e publikut mbi çështjet kryesore të politikave, mbi reformat dhe performancën e sektorit të sigurisë, prirjet evropiane dhe globale të sigurisë, debatin aktual dhe të ardhshëm mbi fushat prioritare të NATO-s, sfidat e Shqipërisë për reformimin e institucioneve dhe qeverisjes në sektorin e sigurisë, çështjet e debatueshme dhe partneritetet e NATO-s me BE-në dhe organizatat e tjera ndërkombëtare.

Nëpërmjet studimeve të realizuara nga ekspertë të fushave përkatëse si dhe kontributit të studiuesve të ndryshëm, Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim, sjell në vëmendje në numrin e ri të kësaj reviste, analiza e rekomandime të kryera së fundmi të përqendruara në disa tematika kryesore që lidhen me sfidat e ardhshme të NATO-s si terrorizmi, siguria kibernetike, siguria e energjisë, angazhimet e Samitit të kësaj organizate në Varshavë.

Në këtë kontekst ky numër e trajton këtë ngjarje lidhur me kontekstin e zhvillimeve rajonale, por edhe më gjerë, duke u fokusuar gjithashtu në strategjitë mbi sigurinë, mbrojtjen kolektive, menaxhimin e situatave të krizës etj.

PSE NATO DO TË VAZHDOJË T'U REZISTOJË DHE MBIJETOJË SFIDAVE BASHKËKOHORE GLOBALE?

Redion Qirjazi[1]

1. Abstrakt

Pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik shumë besonin se NATO i kishte tejkaluar nevojat për ekzistencë. Megjithatë, çerek shekulli më pas NATO vazhdon të mbijetojë madje duke shfaqur shenja zgjerimi të mëtejshëm. Sfidat e fundit të sigurisë globale të cilat kanë bërë që SHBA të fokusohet gjithmonë e më shumë në Azinë Juglindore kanë ngritur shqetësime se interesi i saj karshi NATO-s mund të bjerë dhe bashkë me të dhe vetë qëndrueshmëria e ardhshme e Aleancës. Ky shkrim prezanton një panoramë ndryshe dhe argumenton se pavarësisht ndryshimeve të shumta gjeostrategjike të viteve të fundit, NATO, për shkak të adaptueshmërisë dhe interesit thelbsor të SHBA-ve për të qenë pjesë e saj, do të vazhdojë të jetë një Aleancë solide që nuk rrezikon të shpërbëhet apo dobësohet në të ardhmen e afërt.

[1] MA në Strategji Sigurie të Aplikueshme

2. Me shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik dhe fokusimin gjithmonë e në rritje të SHBA-ve mbi Kinën, çfarë rezervon e ardhmja për NATO-n?

Pothuajse çerek shekulli pas rënies së Bashkimit Sovjetik, Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO),[2] e cila u themelua për t'ju kundërvënë kërcënimit Sovjetik, vazhdon të ekzistojë. Ndërkohë që NATO përballet njëkohësisht me shqetësime të reja ashtu si dhe të vjetra, shumë prej vendeve anëtare vazhdojnë të shfaqin mungesë angazhimi karshi Aleancës duke mos shpenzuar proporcionalisht në krahasim me PBB-në e tyre.

Mosmarrëveshjet politike në çështje sigurie si Kosova, Iraku, Afganistani dhe së fundmi aneksimi Rus i Ukrainës, duket të kenë ndikuar në marrëdhëniet e brendshme të NATO-s. Kjo duket në kontestimin që pati midis disa vendeve të NATO-s në lidhje me masat karshi Rusisë pas ndërhyrjes në Ukrainë si dhe reflektohet në nivelet e ulëta të investimeve në sektorin e mbrojtjes.

Nga ana tjetër, ngritja e vazhdueshme e Kinës në një kërcënim të mundshëm global, vazhdon t'i shtyjë Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) të kundërpërgjigjen unilateralisht për ta kundërbalancuar atë.[3]

[2] North Atlantic Treaty Organization, "A Short History of NATO" http://.nato.int/history/nato-history.html

[3] Cambell, Kurt and Brian Andres, "Explaining the US 'Pivot' to Asia", p. 8, Chatham House, August 2013. https://.chathamhouse.org/sites/files/chathamhouse/public/Research/Americas/0813pp_pivottoasia.pdf

Ky fokus i ri i SHBA-ve hap pyetje të reja në lidhje me prioritetet e saj në fushën e sigurisë dhe ngre dyshime për përkushtimin që ajo ka karshi Aleancës. Gjithsesi, ndonëse NATO po shfaq stërmundime në sfidat aktuale, zgjerimi i saj i viteve të fundit si dhe tendencat e ardhshme për zgjerim, janë indikatorë të vendosmërisë për të mbijetuar dhe për t'u transformuar në një organizatë të qëndrueshme.

Tashmë NATO ka 28 vende anëtare në aleancë në krahasim me 16 në vitin 1991 dhe së fundmi i ka shtrirë ftesën formale për bashkim edhe Malit të Zi.[4] Duke marrë në konsideratë ndikimin e madh gjeostrategjik të NATO-s, sfidat aktuale të sigurisë hedhin hije dyshimi mbi të ardhmen e Aleancës; nëse ajo do të vazhdojë të ruajë rëndësinë që ka në këtë *status quo* apo nëse influenca e saj do të zvogëlohet drejt një shpërbërjeje të mundshme.

Ky shkrim do të mbrojë tezën se NATO nuk do të shpërbëhet pavarësisht mosangazhimit të plotë të të gjithë anëtarëve, mungesës së unitetit politik të plotë, besueshmërisë së lëkundur apo dhe fokusit të SHBA-ve në Azinë Juglindore. Ky shkrim do të argumentojë gjithashtu se NATO do të vazhdojë të ekzistojë sepse: (1) po përshtatet me sfidat e reja strategjike ndërkohë që respekton detyrimet themeltare të krijimit, (2) kërcënimet konvencionale vazhdojnë të mbeten një shqetësim i rëndësishëm global dhe (3) më e rëndësishmja, SHBA e

[4] North Atlantic Treaty Organization, "Alliance Invites Montenegro to Start Accession Talks to Become Member of NATO", 2 December 2015. http://.nato.int/cps/en/natohq/nes_125370.htm

shikon NATO-n si një pjesë integrale të fuqisë së saj globale dhe është e angazhuar për ta ruajtur Aleancën.

'Shpërbërje', për shkak të këtij artikulli, nënkupton kushtin sipas të cilit Aleanca do të dështonte t'i qëndronte besnike parimit të saj themelues për "mbrojtje kolektive", ku specifikohet se "një sulm i armatosur kundër njërit... do të konsiderohet si sulm kundrejt të gjithëve"[5], ose tërheqja e një ose më shumë anëtarëve nga Aleanca, që mund të nënkuptonte dhe një shpërndarje formale të NATO-s.

3. Sfidat e tashme dhe të ardhshme të NATO-s

Ndonëse NATO ka mundur të qëndrojë e bashkuar, për t'i paraprirë më së miri të ardhmes së saj, është e rëndësishme të vëzhgojmë me kujdes disa nga sfidat që ajo ka hasur që pas rënies së Bashkimit Sovjetik. Stephen alt beson se aleancat shpërbëhen nëse ka ndryshim në perceptimin e kërcënimit nga ndonjë prej anëtarëve të aleancës, nëse një prej anëtarëve të aleancës gjen mënyra alternative për vetëmbrojtje ose nëse përgjatë viteve besueshmëria e aleancës dëmtohet.[6] Pavarësisht nga kjo, NATO është përballur me shumë prej sfidave që parashtron alt dhe ka mbijetuar.

[5] NATO founding document, "The North Atlantic Treaty", ashington D.C. 4 April 1949, available at: http://.nato.int/cps/en/natolive/official_texts_17120.htm

[6] Stephen alt, "hy alliances endure or collapse", Survival, 39:1 (London : International Institute for Strategic Studies), pp. 158-161

Së pari, Aleanca i ka tejkaluar limitet e qëllimit themelues, "zmbrapsjen e Bashkimit Sovjetik dhe zgjidhjen e problemit Gjerman."[7] Së dyti, me ndryshimin e natyrës së kërcënimeve ndryshoi dhe mënyra se si anëtarët e aleancës e projektonin veten e tyre në arenën ndërkombëtare dhe se si ata i perceptonin kërcënimet: bashkëpunimi për garantimin e një sigurie më të madhe fitoi prioritet kundrejt konkurrencës për siguri (një gjë e zakontë gjatë viteve të Luftës së Ftohtë).[8] Së fundmi, zhvillimet në Kosovë dhe Afganistan dëmtuan besueshmërinë e NATO-s duke e vendosur atë në një situatë që dëshmonte paaftësi për të "sistemuar shtëpinë e vet."[9] Këto ndryshime gjeostrategjike që rezultuan nga rënia e Bashkimit Sovjetik bënë që anëtarët e NATO-s të sillen sipas interesave të reja politiko-ekonomike duke dobësuar, si pasojë, unitetin e aleancës. Më poshtë do të parashtrohen tre arsye që vazhdojnë të nënvlerësojnë efektivitetin e NATO-s dhe mund të kërcënojnë të ardhmen e saj (të paktën në teori).

Së pari, vendet e NATO-s kanë dëshmuar vazhdimisht një mungesë konsensusi në lidhje me politikat dhe veprimet e Aleancës, duke dëmtuar kështu *besueshmërinë* e tyre. Lufta e Bosnjës, ndërhyrja në Kosovë dhe misioni ISAF në Afganistan janë shembuj të sfidave të

[7] Amos Perlumutter, "The Corruption of NATO: The Alliance Moves East", in NATO Enters the 21st Century, edited by Ted Galen Carpenter (Cato Institute, 2001), p. 129

[8] Luis Simon, "Geopolitics, Grand Strategy and the EU-NATO Conundrum", in Geopolitical Change, Grand Strategy and European Security: The EU-NATO Conundrum in Perspective, (Institute for European Studies, 2013), p. 24

[9] MË. J. illiams, "NATO, Security and Risk Management: from Kosovo to Kandahar and Beyond", in NATO, Security and Risk Management: from Kosovo to Kandahar, (Contemporary Security Studies, 2009), p. 2

bashkëpunimit mes shteteve anëtare. Megjithatë, ndonëse bashkëpunimi ka qenë i vështirë, nën udhëheqjen e SHBA-ve, NATO ka arritur të ruajë efikasitetin dhe rrjedhimisht besueshmërinë e saj. Në fakt, udhëheqja amerikane ka qenë thelbësore për garantimin e rezultateve efektive dhe ruajtjes së reputacionit të Aleancës. Ky argument do të analizohet më në hollësi në vijim të artikullit.

Në Bosnjë NATO u kritikua për mos reagim në kohën e duhur. Madje edhe pas ndërhyrjes, ngjarjet në Srebrenicë e dëmtuan rëndë imazhin dhe besueshmërinë e NATO-s si një forcë në shërbim të paqes dhe sigurisë. Sipas Richard Rupp "nëse NATO do të kishte qenë vërtet efektive në Bosnjë, mund të kishte krijuar besueshmërinë e mjaftueshme për ta bërë Sllobodan Milosheviçin të tërhiqej nga shkatërrimi i Kosovës."[10]

Padyshim, humbja e besueshmërisë së NATO-s dëmtoi më shumë SHBA-të pasi vendoste në pikëpyetje udhëheqjen dhe aftësinë amerikane për të influencuar vendimet e Aleancës dhe për të garantuar sigurinë në Evropë, veçanërisht në një periudhë kur dukej se Aleanca e kishte tejkaluar nevojën për të ekzistuar (që pas rënies së Bashkimit Sovjetik). Rrjedhimisht, NATO kishte nevojë për transformim dhe një mision të ri për të mbijetuar, prandaj, liderët e SHBA argumentuan se

[10] Richard Rupp (2000) "NATO 1949 and NATO 2000: From Collective Defense Toard Collective Security", p. 174, Journal of Strategic Studies, 23:3, 154-176, DOI: 10.1080/01402390008437804

"nëse NATO nuk do të dilte nga zona e saj e përgjegjësisë, do të mbetej pa punë."[11]

Kosova ishte momenti perfekt ku Aleanca dëshmoi angazhimin e saj të ri dhe shtroi rrugën për transformimet e saj të ardhshme. Gjithsesi, ndërhyrja në Kosovë pati sfidat e saj të brendshme veçanërisht në lidhje me konsensusin për ndërhyrje. Përveç vetos së pritshme të Rusisë në Këshillin e Sigurimit (që do t'i mundësonte NATO-s të ndërhynte mbi bazat e nenit 1 të Kombeve të Bashkuara), Franca hezitonte të mbështeste ndërhyrjen.

Kjo mungesë konsensusi si dhe perceptimi i një "përfshirjeje Evropiane" e dobësoi edhe më shumë besueshmërinë dhe vendosmërinë e NATO-s.[12] Por, falë këmbënguljes së SHBA-ve, në përfundim, ndërhyrja në Kosovë e përmirësoi besueshmërinë e NATO-s si një forcë që do sillte ndryshime pozitive dhe për më tepër, "duke marrë rolin e liderit gjatë ndërhyrjes në Kosovë, SHBA-të vendosën frerët drejtues të organizatës për të ardhmen."[13]

Sipas Murray Williams, ndërhyrja në Afganistan nuk dëshmoi mungesë kohezioni por angazhimi, pasi pjesa më e madhe e vendeve evropiane

[11] Ibid., 175

[12] G. Gerard Ong (2003), "Credibility over Courage: NATO's Mis-Intervention in Kosovo", pp. 83, 95, Journal of Strategic Studies, 26:1, 73-108, DOI: 10.1080/01402390308559309

[13] Robert . Rauchhaus (2000), "Explaining NATO Enlargement", p. 176, Contemporary Security Policy, 21:2, 173-194, DOI: 10.1080/13523260008404261

të NATO-s e konsideronin këtë konflikt si një problem të SHBA-ve.[14] Pamundësia për të prodhuar sukses të prekshëm në këtë fushatë ngriti shqetësime për të ardhmen e Aleancës, por në përfundim koalicioni i drejtuar nga SHBA-të dëshmoi qëndrueshmëri përballë misioneve jashtë zonës së influencës së NATO-s.[15]

Së dyti, pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, anëtarët e Aleancës shfaqën një vullnet të ulët për të shpenzuar për buxhetin ushtarak duke "përfituar falas" (*free-ride*) në kurriz të shteteve lider të Aleancës, specifikisht SHBA-të. Për shumë nga shtetet e NATO-s perceptimi i një niveli më të ulët kërcënimi shkaktoi një ulje të buxheteve të mbrojtjes. Sipas të dhënave zyrtare të NATO-s, në vitin 1990 vetëm Luksemburgu investonte më pak se 2% të PBB në fushën e mbrojtjes, por menjëherë pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, 5 shtete anëtare filluan të investonin më pak se 2% të PBB në mbrojtje.[16]

Të dhënat dëshmojnë për një varësi pozitive midis uljes së perceptimit të kërcënimeve të jashtme dhe zvogëlimit të investimeve në fushën e mbrojtjes. Trendi vazhdon të përkeqësohet deri në 2015, kur vetëm 5 nga 28 vende anëtare përmbushin kriterin e dakordësuar për investim 2% të PBB në fushën e mbrojtjes. Natyrisht koncepti i *'free-riding'* që

[14] MË. J. illiams, "Managing Strategic Risk Abroad: Afghanistan", in NATO, Security and Risk Management: from Kosovo to Kandahar, (Contemporary Security Studies, 2009), pp. 87-89.

[15] Ibid., 87-89

[16] NATO Press Release MË-DPC-2(92)100, "Financial and Economic Data Related to NATO Defense", 10 December 1992, p. 5.
http://.nato.int/nato_static_fl2014/assets/pdf/pdf_1992_12/20100827_1992-100.pdf

nënkupton përfitimin e sigurisë nën shpenzimet e një shteti tjetër, ka ekzistuar edhe më parë, por të dhënat dëshmojnë për një rritje të këtij fenomeni.[17]

Gjatë viteve të Luftës së Ftohtë, ndonëse vendet më pak të fuqishme të NATO-s i mbanin shpresat në mbështetjen e fuqive të mëdha (veçanërisht SHBA-ve) për zmbrapsjen e kërcënimeve, ato ruanin një gjendje 'natyrale' të mbrojtjes (në përputhje me kapacitetet e tyre) duke ditur që në rast konflikti, në fund të fundit, do t'u duhej të mbështeteshin në forcat e tyre për të garantuar mbijetesën. Shtetet evropiane ishin dakord me objektivat e përgjithshme të Aleancës, sepse "nuk shikonin asnjë alternativë përveç adoptimit të konceptit Amerikan në përmbushjen e interesave të Aleancës."[18] Gjithsesi qasja e '*free riding'* mbi kurrizin e shteteve të fuqishme ishte e pashmangshme duke qenë se shtetet më të dobëta nuk mund të ofronin kapacitete të mjaftueshme për të zmbrapsur apo mposhtur kërcënimin Sovjetik në një epokë bërthamore.

Gjatë viteve '90 shtetet evropiane nuk përballeshin më me kërcënime ekzistenciale për sigurinë e tyre dhe Evropa po kalonte një periudhë të konflikteve etnike dhe ndërshtetërore. NATO po transformohej nga një aleancë ushtarake që ofronte mbrojtje kolektive në një komunitet të

[17] NATO Press Release PR/CP (2015)093-COR1, "Financial and Economic Data Related to NATO Defense", 22 June 2015, p. 6.
http://.nato.int/nato_static_fl2014/assets/pdf/pdf_2015_06/20150622_PR_CP_2015_093-v2.pdf

[18] Larence Kaplan, NATO Divided, NATO United: The Evolution of an Alliance, (estport, Connecticut 2004), p. 8

fokusuar gjithmonë e më shumë në menaxhim të çështjeve të sigurisë dhe riskut global.[19] '*Free riding*' në kurriz të superfuqive u bë edhe më i dukshëm pas përfundimit të Luftës së Ftohtë sidomos duke konsideruar vendosmërinë e SHBA-ve për përmirësimin e "marrëdhënieve ekonomike trans-Atlantike."[20]

Sipas Alan Tonelson, problemi bazë qëndron në faktin se Amerika dërgon vazhdimisht sinjale të përziera karshi vendeve Evropiane. Nga njëra anë SHBA insiston që vendet e Evropës të kontribuojnë më shumë në mbrojtjen e përbashkët, ndërkohë që në anën tjetër vazhdon të theksojë rëndësinë e madhe që ka lidhja trans-Atlantike për Amerikën.[21] Prandaj, pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, SHBA shërbeu si katalizator për shumë shtete Evropiane që të zvogëlonin investimet në fushën e mbrojtjes duke menduar se siguria e tyre do të vazhdonte të sigurohej nga SHBA-të.

Por, edhe pse ky fenomen i garantimit të sigurisë me kosto për SHBA ka qenë i përhapur përgjatë gjithë ekzistencës së NATO-s, nuk ka ndikuar aspak në nënvlerësimin e unitetit të Aleancës. Në lidhje me këtë, Robert Jarvis argumenton se edhe kur shtetet e vogla plotësojnë detyrimet e tyre ekonomike karshi Aleancës, në momentin kur kjo gjë

[19] MË. J. illiams, "From Security Community to Risk Community: NATO's Evolution", in NATO, Security and Risk Management: from Kosovo to Kandahar, (Contemporary Security Studies, 2009), pp. 33-35

[20] Alan Tonelson (2000) "NATO Burden-Sharing: Promises, Promises", p.29, Journal of Strategic Studies, 23:3, 29-58, DOI: 10.1080/01402390008437799

[21] Ibid., 45-48

nuk ndikon më në sigurinë e përgjithshme të vendeve të fuqishme bërthamore, atëherë dhe mungesa e plotë e investimeve nuk do të shkaktonte shqetësim për organizatën në tërësi.[22] Për më tepër shumë vende Evropiane kanë kuptuar që përfitimi i sigurisë në kurriz të SHBA-ve është i pashmangshëm, sepse siç e thekson dhe ish Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Lord George Robertson, "vendet Evropiane të NATO-s mund të dyfishonin kapacitetet e tyre dhe përsëri nuk do të ishin të afta të bënin shumë pa SHBA-të."[23] Padyshim ky fakt ka qenë gjithmonë evident dhe për SHBA.

Alexander Lanoszka beson se vendet evropiane nuk po përfitojnë në kurriz të SHBA-ve; përkundrazi, në shumë mënyra SHBA e inkurajon këtë fenomen sepse "liderët Amerikanë duan që vendet Evropiane të përmirësojnë mbrojtjen e tyre *deri në një limit të caktuar* [theksim i shtuar]."[24] Kjo nënkupton se Amerika ka interes të mbajë Evropën të ndërvarur në fushën e sigurisë në mënyrë që të garantojë vazhdueshmëri të influencës së saj në kontinentin Evropian dhe evitimit të një kundërbalancimi të mundshëm nga shtetet Evropiane.

Pra, pavarësisht sfidave të brendshme si mosndarja e barabartë e barrës së sigurisë, mosmarrëveshjet politike dhe besueshmëria i lëkundur në

[22] Robert Jervis, The Meaning of the Nuclear Revolution (Ithaca, NY: Cornell University Press, 1989), pp. 36-7

[23] George Robertson, as quoted in Alan Tonelson (2000) "NATO Burden-Sharing: Promises, Promises", p.29, Journal of Strategic Studies, 23:3, 29-58, DOI: 10.1080/01402390008437799

[24] Alexander Lanoszka (2015) "Do Allies Really Free Ride?", p. 146, Survival, 57:3,133-152, DOI: 10.1080/00396338.2015.1046229

momente të veçanta, duket qartë se NATO vazhdon të rezistojë kryesisht falë këmbënguljes së SHBA-ve në këtë çerek shekullin e fundit pas rënies së Bashkimit Sovjetik.

4. Pse sfidat e reja të sigurisë në Azinë Juglindore nuk do të ndikojnë në qëndrueshmërinë e NATO-s?

NATO nuk do të shpërbëhet në të ardhmen e afërt për disa arsye. Së pari, NATO po transformohet dhe përshtatet me kërcënimet e reja të sigurisë. Pas rënies së Bashkimit Sovjetik mjedisi i sigurisë ndryshoi në mënyrë drastike në Evropë. Aleanca filloi të shqetësohej për pasojat e sigurisë që do të rezultonin nga paqëndrueshmëria rajonale që mund të lindte nga mosmarrëveshjet territoriale, problemet social-ekonomike, rivalitetet etnike dhe konfliktet e armatosura në Evropën Qendrore dhe Juglindore.[25] NATO rishikoi politikat e saj për të vepruar jashtë zonës së përgjegjësisë dhe për të integruar më pas vende të tjera Evropiane në Aleancë përmes programeve të quajtura *Partnership for Peace/ Partneriteti për Paqe*. Qëllimi ishte ndikimi i vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore për të zhvilluar ushtri dhe procese vendimmarrjeje të përputhshme me ato të NATO-s duke mundësuar në këtë mënyrë transparencë dhe bashkëpunim të cilat do t'i shtronin rrugën anëtarësimit të këtyre vendeve në NATO.[26] Skema, së bashku

[25] Richard Rupp (2000) "NATO 1949 and NATO 2000: From Collective Defense toard Collective Security", p. 161-162, Journal of Strategic Studies, 23:3, 154-176, DOI: 10.1080/01402390008437804

[26] Ibid., 164-165

me ndikimin ideologjik dhe gjeopolitik, qenë aq efektive sa mundësuan zgjerimin e NATO-s me 12 shtete të tjera Evropiane që pas rënies së Bashkimit Sovjetik.

Sulmet terroriste të 11 shtatorit 2001 krijuan një ortek problemesh të sigurisë globale, veçanërisht pasi SHBA kërkoi aplikimin e Nenit 5 për herë të parë në historinë e Aleancës ('sulm ndaj njërit konsiderohet si sulm ndaj të gjithëve'). Tal Alkopher analizon me kujdes mënyrën sesi komunikimi strategjik i NATO-s ndryshoi teksa ajo ndërmerrte politika të reja në misionet e saj jashtë territorit.

Në fakt, duke analizuar retorikën e politikave të NATO-s pas 11 shtatorit, duket qartë transformimi dhe përshtatja e NATO-s me kërcënimet e sigurisë në zhvillim e sipër. Sipas Alkopher, Aleanca u përfshi gjithmonë e më shumë në misione jashtë fushës së mbrojtjes kolektive dhe sigurisë duke përqafuar një rol më të gjerë si një aktor që synon stabilitet dhe mundëson paqe ndërkombëtare dhe siguri në përgjigje të krizave të sigurisë që mund të ndikojnë në të ardhmen në sigurinë e vendeve të Aleancës.[27] Pra, pavarësisht nëse zgjerimi vjen si pasojë e vakumit të pushtetit që u krijua nga rënia e Bashkimit Sovjetik apo si përgjigje ndaj sfidave të reja të sigurisë në shekullin e 21-të, është e rëndësishme të vërehet se NATO vazhdon të ruajë rëndësinë e

[27] Tal Dingott Alkopher (2015): "From Kosovo to Syria: the transformation of NATO Secretaries General's discourse on military humanitarian intervention", p. 5-10, European Security, DOI: 10.1080/09662839.2015.1082128

saj duke u përshtatur dhe transformuar strategjinë për t'ju përgjigjur këtyre sfidave përkatësisht.

Së dyti, NATO do të vazhdojë të qëndrojë e bashkuar si rrjedhojë e një sistemi të përbashkët vlerash dhe ndërvarësie midis anëtarëve. NATO është "një aleancë e demokracive liberale,"[28] argumenton Wallace Thies; dhe si e tillë ajo zotëron "fuqi të brendshme që do ta mundësonin të qëndronte e bashkuar pavarësisht problemeve konstante që ajo has."[29] Ndonëse ky argument në vetvete nuk përfaqëson arsyen primare të qëndrueshmërisë së NATO-s si aleancë, padyshim paraqet një argument të vlefshëm. Në fund të fundit, NATO nuk është si asnjë aleancë tjetër.

Përgjatë viteve NATO ka mbështetur integrimin demokratik të shumë vendeve evropiane, ka promovuar marrëdhënie paqësore dhe fqinjësi të mirë, ka vendosur standarde të larta ndërveprueshmërie dhe transparence si dhe ka stimuluar bashkëpunimin ekonomik dhe politik. Williams beson se këmbëngulja e vazhdueshme e Aleancës karshi "demokracisë, lirisë individuale dhe forcës së ligjit" e ka bërë atë një "bastion të vlerave liberale-demokrate dhe një burim stabiliteti" për të ardhmen.[30]

[28] Wallace J. Thies, "Why NATO Endures", 1st ed. (Cambridge: Cambridge University Press, 2009), p. 287

[29] Ibid., 294

[30] MË. J. Williams, "Conclusion: Transatlantic Insecurity and the Future of NATO", in NATO, Security and Risk Management: from Kosovo to Kandahar, (Contemporary Security Studies, 2009), p. 116

I të njëjtit mendim, por me më shumë skepticizëm, janë dhe Rühle and Williams të cilët besojnë se NATO është arsyeja parësore që promovon marrëdhënie të mira transatlantike. Në fakt sipas tyre, arsyeja kryesore pse NATO do të vazhdojë të ekzistojë është sepse "nuk ekziston asnjë marrëdhënie transatlantike e rëndësishme që nuk përfshin apo nënkupton bashkëpunimin me NATO-n."[31] Për këtë arsye, për aq kohë sa do të ekzistojnë bashkëpunime *madhore* midis Evropës dhe SHBA-ve (qoftë politike apo ekonomike), NATO do të jetë gjithmonë e pranishme si element garantues i sigurisë. Ky fakt e vendos NATO-n në qendër të bashkëpunimit Amerikano-Evropian. Optimistë të Aleancës si Patrick Keller besojnë se NATO mund të shërbejë si një organizatë e gjithëpushtetshme për t'ju përgjigjur të gjitha problemeve të sigurisë dhe në të njëjtën kohë mund të sigurojë përhapjen e vlerave liberale dhe demokratike në botë. Keller beson se:

> *Evropa dhe siguria e kontinenteve Evropian dhe Amerikan duhet të mbeten arsyeja që e mban NATO-n të bashkuar. Por ky qëllim thelbësor nuk do të kishte kuptim nëse nuk plotësohet nga promovimi i vlerave liberale si liria, demokracia dhe të drejtat e njeriut. Duke ndjekur rigorozisht interesat globale të sigurisë ndërkohë që përhap dhe mbron vlerat e saj, NATO mund të hapë rrugë të reja.*[32]

[31] Michael Rühle & Nick illiams (1997), "hy NATO ill Survive", p. 114, Comparative Strategy, 16:1, 109-115, DOI: 10.1080/01495939708403093

[32] Patrick Keller (2007), "The Future of NATO: Beteen Overstretch and Irrelevance", p. 215, American Foreign Policy Interests, 29:3, 207-217, DOI: 10.1080/10803920701451863

Vlerat e përbashkëta, interesat dhe ndërvarësia e shteteve të NATO-s e kanë bërë këtë aleancë të qëndrueshme ndaj sfidave të sigurisë dhe e kanë çimentuar unitetin e saj jo vetëm në fushën e sigurisë por gjithashtu dhe në fushën e bashkëpunimit social-politik dhe kulturor. Gjithsesi, do të ishte naive të presupozohej që ndryshimet reale politike mund të ndodhin natyrshëm nga përbrenda organizatës pa vlerësuar rolin që aktorët specifikë kanë brenda saj.

Në realitet, ndonëse shtetet anëtare ndajnë disa vlera dhe kanë ngjashmëri, ato kanë gjithashtu dhe shumë ndryshime. Ndryshimet mund të jenë ekonomike, social-politike apo kulturore, dhe përcaktojnë veprimet individuale të shteteve si dhe aftësinë e tyre për të ndikuar në vendimmarrjen e përgjithshme të Aleancës. E thënë ndryshe, NATO vazhdon të jetë një organizatë e përbërë nga shtete sovrane me axhenda të ndryshme politike dhe kombëtare dhe aftësia e tyre për të influencuar politikat e NATO-s varet nga pushteti relativ që ato gëzojnë brenda organizatës.

Momentalisht, SHBA-të kanë pushtet relativ të padiskutueshëm në krahasim me çdo vend tjetër anëtar. Kështu beson dhe Richard Rupp i cili shprehet se "NATO i mundëson Shteteve të Bashkuara një fleksibilitet të konsiderueshëm në mënyrën se si ndërvepron në çështjet e sigurisë ushtarake të Evropës. Përmes këtij pozicioni në Aleancë,

Shtetet e Bashkuara mund të përshtatin dhe drejtojnë rrjedhën e debateve dhe vendimmarrjeve."[33]

Prandaj, arsyeja e tretë, dhe ndoshta më e rëndësishmja, se pse NATO nuk do të shpërbëhet është sepse hegjemonia e SHBA-ve e garanton këtë vazhdueshmëri. Ekzistenca dhe evolucioni i NATO-s është e lidhur ngushtë me pozitën që SHBA-të kanë në rendin ndërkombëtar. Në lidhje me këtë, alt shprehet se "ekzistenca e një superfuqie hegjemonike që shërben si lider në një aleancë"[34] është një kusht i rëndësishëm për mbijetesën e një aleance. Prandaj, për aq kohë sa SHBA është e interesuar të ruajë statusin e saj hegjemonik, ajo do të vazhdojë të shfaqë interes në qëndrueshmërinë e NATO-s. Christopher Layne, një mbështetës i kësaj teorie të realizmit ofensiv argumenton se:

> *NATO shërben për të avancuar një sërë objektivash të ndërlidhura të strategjisë madhore Amerikane për Evropën e pas Luftës së Ftohtë: ajo mundëson stabilitet për kontinentin; vendos një kapak mbi rivalët gjeopolitikë Evropianë; krijon ambientin e sigurisë sipas të cilit ndërvarësia ekonomike mund të lulëzojë; dhe ngadalëson ngritjen e fuqive Evropiane që mund të sfidojnë dominimin Amerikan. Pra NATO është instrumenti përmes së cilit SHBA përjetëson rolin e saj hegjemonik në Evropë.*[35]

[33] Richard Rupp (2000) "NATO 1949 and NATO 2000: From Collective Defense Toard Collective Security", p. 175, Journal of Strategic Studies, 23:3, 154-176, DOI: 10.1080/01402390008437804

[34] Stephen alt, "hy alliances endure or collapse", Survival, 39:1 (London : International Institute for Strategic Studies), p. 164

[35] Christopher Layne (2000) "US hegemony and the perpetuation of NATO", p. 73, Journal of Strategic Studies, 23:3, 59-91, DOI: 10.1080/01402390008437800

Argumenti i Layne përputhet me shumicën e zhvillimeve gjeostrategjike midis SHBA-s dhe vendeve Evropiane të NATO-s, ndërsa SHBA vepron me vendosmëri dhe modifikon politikat e NATO-s edhe shtetet Evropiane i pranojnë këto vendime dhe rrjedhojat politike e ushtarake të tyre. Në 1996, ndonëse lufta e Bosnjës po zhvillohej nën hundën e vendeve Evropiane, ishte SHBA dhe jo vendet Evropiane të NATO-s që i dhanë shtysë ndërhyrjes ushtarake, mundësuan arritjen e Marrëveshjes së Paqes të Dayton-it dhe në fund drejtuan një koalicion ushtarak prej 60,000 trupash për vendosjen dhe ruajtjen e paqes.[36] Historia përsëriti vetveten gjatë luftës së Kosovës kur, e përballur me mungesën e vendosmërisë së vendeve Evropiane, SHBA mori vendimin të ndërhynte kundër Serbisë unilateralisht; shumë shpejt pas marrjes së këtij vendimi, vendet e tjera të NATO-s ndoqën Amerikën në veprimet e saj.[37]

I njëjti lidership vërehet dhe në Afganistan dhe Irak, ku SHBA orkestroi dhe drejtoi të dyja fushatat ushtarake.[38] Është e qartë që SHBA ka interesa në Evropë. Qoftë teoritë e realizmit ofensiv por dhe situata në praktikë mbështesin idenë se SHBA, si fuqia hegjemonike më e madhe e botës, do të vazhdojë të synojë ruajtjen e dominimit që ka arritur. Për ta realizuar këtë, SHBA vazhdon të zgjerojë influencën e

[36] Alexander B. Dones (2004), "The Problem ith Negotiated Settlements to Ethnic Civil ars", p. 252, Security Studies, 13:4, 230-279, DOI: 10.1080/09636410490945893

[37] Ibid., 267-273

[38] MË. J. illiams, "Risk Managed or Manufactured: Iraq and the Precautionary Principle", in NATO, Security and Risk Management: from Kosovo to Kandahar, (Contemporary Security Studies, 2009), pp. 90-91

saj në Evropë përmes NATO-s në mënyrë që të reduktojë vakumet e pushtetit brenda kontinentit dhe të parandalojë rishfaqjen e rivalëve të ardhshëm, ndërkohë që maksimizon fuqinë e saj relative.[39] SHBA është hegjemoni global i ditëve tona dhe për aq kohë sa ajo dëshiron ta ruajë këtë status, do të vazhdojë të mbajë influencë të vazhdueshme në Evropë përmes NATO-s. Në vetvete, ky akt (prezenca e garantuar e SHBA-ve në Evropë) do të garantojë qëndresën dhe vazhdueshmërinë e NATO-s. Teorikisht, SHBA do të vazhdojë të ruajë statusin e saj për aq sa të mundet; por edhe në realitet, ka shumë pak gjasa që *status quo-ja* të ndryshojë në të ardhmen e afërt.[40]

Pra, nëse e ardhmja e NATO-s lidhet së pari dhe më së shumti me prezencën e SHBA-ve, çfarë do të ndikonte në humbjen e interesit të SHBA-ve dhe distancimin e saj nga kjo aleancë? A do të mundet fuqia në rritje e Kinës në Lindjen e Largët të zhvlerësojë fuqinë relative të SHBA-ve aq sa të detyrohet të zhvendos vëmendjen nga NATO? Më poshtë parashtrohen tre arsye pse kjo gjë nuk ka gjasa të ndodhë.

Së pari, Kina nuk është ende një fuqi globale me peshën e SHBA-s dhe nuk do të mundë të sfidojë hegjemoninë e saj në të ardhmen e afërt për disa arsye si: kufizimet gjeopolitike, popullsia në plakje e sipër, sistemi politik i korruptuar dhe jo-fleksibël, dobësi ushtarake krahasuar me

[39] Hans Morgenthau , revised by Keneth . Thompson, Politics Among Nations: The Struggle for Poer and Peace, 6th ed. (NY: Knopf 1986) p. 378

[40] Ian Bremer, "These are the 5 Reasons hy the U.SË. Remains the orld's Only Superpoer", in Time Magazine, 28 May 2015. http://time.com/3899972/us-superpoer-status-military/

SHBA-në dhe më e rëndësishmja ndërvarësia e lartë ekonomike me perëndimin dhe SHBA-në në veçanti.[41] Sipas Andre Tan, Kinës i duhet shumë kohë dhe përpjekje përpara se të shndërrohet në një hegjemoni globale dhe akoma më shumë që të zëvendësojë SHBA-në. Për më tepër, sipas tij:

> *Ndonëse influenca e Kinës dhe ndikimi i saj do të vazhdojë të rritet me siguri, asaj do t'i duhej të tejkalonte pengesa të mëdha për të qenë një fuqi globale e vërtetë dhe jo më të zinte rolin e SHBA. Do t'i duhej jo vetëm të zhvillonte aftësinë dhe vullnetin për t'u angazhuar globalisht, por gjithashtu dhe një vetëbesim për të ofruar një model të ri ekonomik, politik dhe social që të imitohej nga pjesa tjetër e botës.*[42]

Edhe zhvillimet e kohëve të fundit në Detin e Kinës së Jugut ku Kina ka zaptuar disa territore ishullore të vendeve fqinje, nuk janë shqetësim i madh. Bendan Taylor shprehet se ndonëse Kina mund të ketë interesa të rëndësishme gjeostrategjike në atë zonë, është shumë larg ndikimit të interesave të SHBA në atë rajon dhe për më tepër situata është zmadhuar së tepërmi.[43] Së fundmi, vendimi i gjykatës ndërkombëtare të Hagës më 12 gusht 2016, mbi pronësinë e ujërave territoriale në Detin e Kinës, ku u vendos se shteti i Filipineve ka të drejtën e shfrytëzimit të

[41] Loren Thompson, "Five Reasons China on'të be a Big Threat to America's Global Poer", in Forbes Magazine, 6 June 2014, http://.forbes.com/sites/lorenthompson/2014/06/06/five-reasons-china-ont-be-a-big-threat-to-americas-global-poer/

[42] Andre TË. H. Tan (2014), "hy China is Not a Global Poer", p. 48, The RUSI Journal, 159:5, 42-50, DOI: 10.1080/03071847.2014.969943

[43] Brendan Taylor (2014), "The South China Sea is Not a Flashpoint", pp. 100-103, The ashington Quarterly, 37:1, 99-111, DOI: 10.1080/0163660X.2014.893176

ujërave territoriale, i dha një tjetër goditje imazhit dhe politikës Kineze.[44]

Së dyti, Rusia vazhdon ende të ketë "besueshmëri kërcënuese" në Evropë dhe ngjarjet e para një viti e pak në Ukrainë duket të kenë rizgjuar tensionet e vjetra, duke garantuar në këtë mënyrë një vazhdimësi të interesit të SHBA-ve për Evropën dhe NATO-n. Fosberg dhe Herd janë të mendimit se NATO dhe Rusia kanë pasur gjithmonë marrëdhënie të acaruara me njëra-tjetrën që pas rënies së Bashkimit Sovjetik dhe se bashkëpunimi mes këtyre palëve ka qenë i destinuar të dështojë.[45]

Rusia e shikon zgjerimin e NATO-s në shtetet Baltike, në Ballkan dhe së fundmi në Ukrainë si një provokim dhe kërcënim të sigurisë së saj. Për këtë arsye, aneksimi i Krimesë nga Rusia si dhe skenarë të tjerë të ndërhyrjes në shtetet Baltike janë bërë edhe njëherë "ngjitësi që e mban aleancën të bashkuar... dhe rifarkëton solidaritetin transatlantik."[46] Ky tension duket se vazhdon të rritet ndërkohë që në kulmin e luftës në Siri, SHBA dhe Rusia vazhdojnë të akuzojnë njëri-tjetrin si shkaktarë të konfliktit. Gjithashtu, në tetor 2016 të dyja këto shtete nuk kanë hezituar të shkëmbejnë akuza të drejtpërdrejta politike apo kërcënime

[44] Jane Perlez, "Tribunal Rejects Beijing's Claims on South China Sea" Ne York Times, 12 July 2016, http://.nytimes.com/2016/07/13/orld/asia/south-china-sea-hague-ruling-philippines.html?_r=0.

[45] Tuomas Forsberg & Graeme Herd (2015), "Russia and NATO: From indos of Opportunities to Closed Doors", pp. 41-42, Journal of Contemporary European Studies, 23:1, 41-57, DOI: 10.1080/14782804.2014.1001824

[46] Ibid., pp. 54-55

ushtarake që vijnë si rezultat i konkurrencës gjeostrategjike në rajonin e Lindjes së Mesme.[47] Përshkallëzimi i këtij konflikti dhe nevoja që SHBA-të mund të kenë për aleatë politikë dhe ushtarakë është një arsye tjetër pse NATO aktualisht nuk rrezikon shpërbërje, madje përkundrazi, ajo mund të konsolidohet edhe më shumë.

Së treti, NATO shikohet si një aktor që garanton siguri dhe faktor që sjell ndryshime pozitive në arenën ndërkombëtare. Pothuajse të gjitha angazhimet ushtarake të Perëndimit që nga lufta në Bosnjë kanë pasur si pjesëmarrës NATO-n. NATO është një organizatë politike dhe një forum ku vendet e Aleancës përcaktojnë politikat që duhen ndjekur në përgjigje të shqetësimeve të sigurisë. Ajo vlerësohet si një nga rastet më të suksesshme të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Ashtu siç rikonfirmoi vetë Presidenti Obama në fjalimin e tij në Bruksel, NATO është një aleancë e vendosur për të mbrojtur vlerat dhe parimet e saj të përbashkëta dhe nuk do të lëkundet kurrë nga misioni i saj parësor për garantimin e sigurisë për të gjitha shtetet anëtare.[48] Duke pasur parasysh faktin se ky fjalim u mbajt shumë afër pas aneksimit të Krimesë nga Rusia, ai linte të kuptohej se SHBA është ende e angazhuar të qëndrojë dhe mbështesë NATO-n, dhe rrjedhimisht

[47] Alexandra Sims, "US and Russia Could 'Start Third orld ar over Syria Conflict', Says Turkey," The Independent, 18 October 2016, http://.independent.co.uk/nes/orld/europe/us-russia-third-orld-ar-syria-conflict-aleppo-turkey-deputy-prime-minister-numan-kurtulmus-a7366571.html.

[48] Barak Obama, (US President), "President Obama Delivers Remarks at Palais des Beaux Arts in Brussels, Belgium", 26 March 2014, Marrë nga: https://.youtube.com/atch?v=qCxLTn6TNaA

edhe NATO do të vazhdojë të jetë një strukturë e qëndrueshme në të ardhmen e afërt.

5. Përmbledhje

NATO nuk do të shpërbëhet, sepse ka më shumë pika të forta se sa të dobëta. Edhe pse NATO ka pësuar një reduktim të fuqisë së saj përmes mos shpërndarjes së barabartë të përgjegjësisë, humbje të besueshmërisë dhe periudhave të caktuara të mosmarrëveshjeve politike, ajo gjithmonë ka arritur të përmbushë me sukses misionet e saj falë vendosmërisë së saj.

Aftësia e NATO-s për t'u adaptuar dhe përshtatur me sfidat në rritje të sigurisë kanë garantuar unitetin e saj. Ndonëse sfidat tradicionale të NATO-s nuk janë të njëjta me ato të Luftës së Ftohtë, ato përsëriten sërish dhe NATO ka gjetur mënyrën për t'i përballur me sukses. Bashkimi në bazë të vlerave si dhe një lidership dhe angazhim i fortë i SHBA-ve për mbushjen e 'boshllëkut të sigurisë' në Evropë pas rënies së Bashkimit Sovjetik janë elementët që e mbajnë Aleancën të bashkuar. Përmes manifestimit si një organizatë politike dhe ushtarake që garanton paqe dhe stabilitet, NATO vlerësohet gjithmonë e më shumë si një forcë për ndryshime pozitive në botë. Duke marr parasysh angazhimin e padiskutueshëm të SHBA-ve në Evropë, NATO do të vazhdojë të gëzojë pushtet dhe të influencojë sigurinë globale në vitet në vijim.

Bibliografia

Alkopher, Tal Dingott (2015), "From Kosovo to Syria: the transformation of NATO Secretaries General's discourse on military humanitarian intervention", *European Security*, DOI: 10.1080/09662839.2015.1082128

Barak Obama, (US President), "President Obama Delivers Remarks at Palais des Beaux Arts in Brussels, Belgium", 26 March 2014, Available at: https://.youtube.com/atch?v=qCxLTn6TNaA

Bremer, Ian, "These are the 5 Reasons hy the U.SË. Remains the orld's Only Superpoer", in *Time Magazine*, 28 May 2015 Available from: http://time.com/3899972/us-superpoer-status-military/

Cambell, Kurt and Brian Andres, "Explaining the US 'Pivot' to Asia", *Chatham House*, August 2013. Available at: https://.chathamhouse.org/sites/files/chathamhouse/public/Research/Americas/0813pp_pivottoasia.pdf

Dones, Alexander B., (2004), "The Problem ith Negotiated Settlements to Ethnic Civil ars", *Security Studies*, 13:4, 230-279, DOI: 10.1080/09636410490945893

Forsberg, Tuomas & Graeme Herd (2015), "Russia and NATO: From indos of Opportunities to Closed Doors", *Journal of Contemporary European Studies*, 23:1, 41-57, DOI: 10.1080/14782804.2014.1001824

Jervis, Robert, *The Meaning of the Nuclear Revolution* (Ithaca, NY: Cornell University Press, 1989), pp. 36-7

Kaplan, Larence, *NATO Divided, NATO United: The Evolution of an Alliance*, (estport, Connecticut 2004), p. 8

Keller, Patrick (2007), "The Future of NATO: Beteen Overstretch and Irrelevance", *American Foreign Policy Interests*, 29:3, 207-217, DOI: 10.1080/10803920701451863

Lanoszka, Alexander (2015) "Do Allies Really Free Ride?", *Survival*, 57:3,133-152, DOI: 10.1080/00396338.2015.1046229

Layne, Christopher (2000) "US hegemony and the perpetuation of NATO", *Journal of Strategic Studies*, 23:3, 59-91, DOI: 10.1080/01402390008437800

Morgenthau, Hans, revised by Keneth . Thompson, *Politics Among Nations: The Struggle for Poer and Peace*, 6th ed. (NY: Knopf 1986) p. 378

NATO founding document, "The North Atlantic Treaty", ashington D.C. 4 April 1949, available at: http://.nato.int/cps/en/natolive/official_texts_17120.htm

NATO Press Release MË-DPC-2(92)100, "Financial and Economic Data Related to NATO Defense", 10 December 1992, p. 5. Available at: http://.nato.int/nato_static_fl2014/assets/pdf/pdf_1992_12/20100827_1992-100.pdf

NATO Press Release PËR/CP (2015)093-COR1, "Financial and Economic Data Related to NATO Defense", 22 June 2015, p. 6.

Available at: http://.nato.int/nato_static_fl2014/assets/pdf/pdf_2015_06/20150622_PËR_CP_2015_093-v2.pdf

North Atlantic Treaty Organization, "A Short History of NATO" Available at: http://.nato.int/history/nato-history.html

North Atlantic Treaty Organization, "Alliance Invites Montenegro to Start Accession Talks to Become Member of NATO", 2 December 2015. Available at: http://.nato.int/cps/en/natohq/nes_125370.htm

Ong, G. Gerard (2003), "Credibility over Courage: NATO's Mis-Intervention in Kosovo", *Journal of Strategic Studies*, 26:1, 73-108, DOI: 10.1080/01402390308559309

Perlez, Jane. "Tribunal Rejects Beijing's Claims on South China Sea." *Ne York Times*, 12 July 2016. Available at: http://.nytimes.com/2016/07/13/orld/asia/south-china-sea-hague-ruling-philippines.html?_r=0.

Perlumutter, Amos, "The Corruption of NATO: The Alliance Moves East", in *NATO Enters the 21st Century*, edited by Ted Galen Carpenter (Cato Institute, 2001)

Rauchhaus, Robert . (2000), "Explaining NATO Enlargement", Contemporary Security Policy, 21:2, 173-194, DOI: 10.1080/13523260008404261

Robertson, George, as quoted in Alan Tonelson (2000) "NATO Burden-Sharing: Promises, Promises", *Journal of Strategic Studies*, 23:3, 29-58, DOI: 10.1080/01402390008437799

Rühle, Michael and illiams, Nick (1997), “hy NATO ill Survive”, *Comparative Strategy*, 16:1, 109-115, DOI: 10.1080/01495939708403093

Rupp, Richard (2000) “NATO 1949 and NATO 2000: From Collective Defense Toard Collective Security”, *Journal of Strategic Studies*, 23:3, 154-176, DOI: 10.1080/01402390008437804

Simon, Luis, “Geopolitics, Grand Strategy and the EU-NATO Conundrum”, in *Geopolitical Change, Grand Strategy and European Security: The EU-NATO Conundrum in Perspective*, (Institute for European Studies, 2013),

Sims, Alexandra. “US and Russia Could ‘Start Third orld ar over Syria Conflict’, Says Turkey.” *The Independent*, 18 October 2016. Available at: http://.independent.co.uk/nes/orld/europe/us-russia-third-orld-ar-syria-conflict-aleppo-turkey-deputy-prime-minister-numan-kurtulmus-a7366571.html.

Tan, Andre TË. H. (2014), “hy China is Not a Global Poer”, *The RUSI Journal*, 159:5, 42-50, DOI: 10.1080/03071847.2014.969943

Taylor, Brendan (2014), “The South China Sea is Not a Flashpoint”, *The ashington Quarterly*, 37:1, 99-111, DOI: 10.1080/0163660X.2014.893176

Tonelson, Alan (2000) “NATO Burden-Sharing: Promises, Promises”, *Journal of Strategic Studies*, 23:3, 29-58, DOI: 10.1080/01402390008437799

Thies, allace J. “hy NATO Endures”, *hy NATO Endures*. 1st ed. (Cambridge: Cambridge University Press, 2009)

Thompson, Loren, “Five Reasons China on’të be a Big Threat to America’s Global Poer”, in *Forbes Magazine*, 6 June 2014, Available at: http://.forbes.com/sites/lorenthompson/2014/06/06/five-reasons-china-ont-be-a-big-threat-to-americas-global-poer/

Walt, Stephen, “hy alliances endure or collapse”, *Survival*, 39:1 (London: International Institute for Strategic Studies)

Williams, MW. J. “Managing Strategic Risk Abroad: Afghanistan”, in *NATO, Security and Risk Management: from Kosovo to Kandahar*, (Contemporary Security Studies, 2009)

Williams, MW. J. “Conclusion: Transatlantic Insecurity and the Future of NATO”, in *NATO, Security and Risk Management: from Kosovo to Kandahar*, (Contemporary Security Studies, 2009)

Williams, MW. J. “NATO, Security and Risk Management: from Kosovo to Kandahar and Beyond”, in *NATO, Security and Risk Management: from Kosovo to Kandahar*, (Contemporary Security Studies, 2009)

SFIDAT URGJENTE: TERRORIZMI, SIGURIA KIBERNETIKE, PROPAGANDA

Greta Tučkutė, Deividas Šlekys

1. Abstrakt

Kriza në Lindjen e Mesme dhe shpërthimi i migracionit masiv drejt Evropës, rritja e ISIS (shtetit islamik), lufta në Ukrainë dhe aneksimi i Krimesë, aktet terroriste në Paris, Bruksel, Stamboll dhe qytete të tjera, kanë nxjerrë në pah anët e dobëta dhe përbëjnë sfida serioze ndaj rendit publik, vlerave demokratike, parimeve themelore dhe rrezikojnë paqen si në vendet e NATO-s po ashtu dhe të fqinjëve të tyre. Sulmi rus në Ukrainë, përfshin një gamë të plotë masash hibride "burrat e vegjël me uniformë të gjelbër", grupet paraushtarake, sulmet kibernetike, propaganda, interpretimi i gabuar i ligjit ndërkombëtar dhe kërcënimi i sigurisë energjetike.

Kompleksiteti i këtyre rreziqeve dhe pasojave të tyre të mundshme i kanë detyruar anëtarët e NATO-s t'u përgjigjen në nivele të ndryshme-njëpalëshe, shumëpalëshe dhe bashkërisht. Nevoja për një përgjigje të fuqishme dhe efektive u theksua në Deklaratën e Samitit të Uellsit në 2014-në, dhe pasoi me Planin e Gatishmërisë për Veprim (PGV) të NATO-s. Qëllimi i këtij shkrimi është të ekzaminojë sfidat urgjente si: terrorizmi, siguria kibernetike dhe propaganda, si dhe masat e nevojshme për t'i luftuar ato.

2. Lufta ndaj terrorizmit – mision i (pa)mundur?

Për të forcuar kohezionin, liderët e SHBA duhet të marrin në konsideratë zgjerimin e debatit përtej shqetësimeve imediate mbi Evropën e trazuar, nxitjen e presionit e vendeve ndër-evropiane në

[3] Instituti për Studime Evropiane në Bruksel

sigurimin e kapaciteteve të duhura ushtarake, dhe nxitjen e vendeve evropiane për të zhvilluar pozicionime të forcave plotësuese. Këto nisma do të mund të rigjallërojnë lidhjet transatlantike, por do të kërkojnë angazhim të duruar para dhe pas samitit.

Thuhet shpesh se kohezioni përbën qendrën e gravitetit të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO). Sidoqoftë, presionet e brendshme të ndryshme dhe perceptimet për kërcënimin e jashtëm, rrezikojnë të përçajnë aleatët dhe të çojnë në prishjen e arkitekturës euroatlantike të sigurisë. Kur krerët e shteteve të NATO-s do të takohen në Varshavë në 8-9 korrik të 2016-ës, pritshmëritë do të jenë të mëdha. Nuk ka ndodhur që prej fundit të Luftës së Ftohtë që gjendja e sigurisë të ketë qenë kaq e zymtë, apo që burimet kolektive të kenë qenë kaq të varfra për t'iu përgjigjur kërcënimeve të shumta.

Ky dokument merr shkas prej debateve ekzistuese në axhendën e Samitit të Varshavës dhe ofron një sërë rekomandimesh se si zyrtarët amerikanë mund të bëjnë të pamundurën për të nxitur unitetin brenda Aleancës. Një rishikim i përciptë i komenteve të ndryshme për axhendën e Samitit të Varshavës tregon se ky ushtrim ka më shumë gjëra të përbashkëta me praktikën e njohur të "organizimit/tufëzimit të maceve"[4]. Aleatët duan të shohin më shumë se sa dëshiron secili

[4] Krahaso, për shembull, Karl-Heinz-Kamp, Axhenda e Samitit të NATO-s në Varshavë (Berlin: Bundesakademie für Sicherheitspolitik, 2015); Trine Flockhart, Një Axhendë për Samitin e NATO-s në Varshavë, 2016: Kthim te Elementaret apo Thjesht Mbrapsht? (Kopenhagen: Instituti Danez për Studime Ndërkombëtare, Gusht 2015); Rainer L. Glatz dhe Martin Zapfe, Planifikimi i Mbrojtjes së NATO-s midis Uellsit dhe Varshavës: Sfidat Politiko-Ushtarake të një Sigurie të Besueshme kundër Rusisë (Berlin: Stiftung issenschaft und Politik, Janar 2016); Job C. Henning

individualisht, ndërkohë që Aleanca si një e tërë rreket të plotësojë kërkesat e ndryshme. është shkruar shumë tashmë për aktin delikat të balancimit që nevojitet për të mbështetur mbrojtjen në lindje dhe jug, si dhe për të pajtuar nevojat e parandalimit me dialogun politik. Megjithatë, menaxhimi i vështirësive diplomatike për gjetjen e konsensusit përmban edhe pranimin se vështirësitë për Aleancën janë sa të brendshme po aq edhe të jashtme.

Kjo analizë vijon si më poshtë. Pjesa e parë trajton çështje të ndryshme të axhendës së Samitit të Varshavës. Ndonëse çështje të caktuara kanë përgjigje logjike, ato shpesh kanë pasoja të konsiderueshme financiare. Për këtë arsye, sfida kryesore për diplomacinë e samitit do të jetë ruajtja e unitetit përtej marrëveshjes së pashmangshme që pajton kërkesat konkurruese për burime. Suksesi nuk mund të merret si i mirëqenë. Tre seksionet në vijim paraqesin një sërë rekomandimesh për tu përballur me sfidën e fragmentimit. Në aspektin e perceptimeve të kërcënimit, një trajtës koherente mund të ndërtohet vetëm duke zhvendosur diskutimin përtej fqinjëve të afërt të Aleancës.

Kjo kërkon që të gjithë aleatët të artikulojnë shqetësimet e tyre të sigurisë dhe integrimin e tyre në një qasje 360-gradë. Për sa i përket burimeve të mbrojtjes, problemi i *"free rider"* mund të trajtohet në

dhe Douglas A. Ollivant, "Rishikimi Radikal ndaj NATO-s dhe e Ardhmja e Sigurisë Evropiane," Lufta në Shkëmbinj, Mars 24, 2016; Michal Baranoski dhe Bruno Lété, NATO në një Botë të Çrregullt: Pergatitja e Aleancës për Varshavën (Uashington, DC: Fondi Marshall në Gjermani i Shteteve të Bashkuara, Mars 2016); Hans Binnendijk, Daniel SË. Hamilton, dhe Charles L. Barry, Rivitalizimi i Aleancës: NATO për një Epokë të Re (Uashington, DC: Qendra për Marrëdhënie Transatlantike, Prill 2016).

mënyrë më efektive duke nxitur presionin ndërmjet vendeve evropiane, përfshirë edhe nëpërmjet Bashkimit Evropian (BE). Angazhimi për shpenzime të mjaftueshme për mbrojtjen duhet të integrohet në sistemin e koordinimit makroekonomik të Semestrit Evropian. SË fundi por jo për nga rëndësia, zhvillimi i kapaciteteve dhe strategjisë duhet të ristrukturohet për t'iu përshtatur ndarjes rajonale të punës që bazohet mbi strukturat plotësuese të forcës. Kjo do të bëj që disa vende që janë më afër kërcënimeve të ndryshme të marrin rolin e reaguesit të parë dhe të tjerët atë të ofruesve të forcave rezervë, mbrojtjes së thelluar dhe të mbështetjes. Seksioni përmbyllës skicon një praktikë pozitive për të transformuar krizën në mundësi. Shtetet e Bashkuara mund ta përdorin Samitin e Varshavës si një katalizator për rivitalizimin e rendit botëror të udhëhequr nga Perëndimi.

2. Axhenda e Varshavës dhe problemi i fragmentimit

Në pamje të par, axhenda e Samitit të Varshavës është e drejtpërdrejtë. Krerët e Shteteve dhe Qeverive të NATO-s do të shqyrtojnë përparimin që është arritur në zbatimin e vendimeve të marra në Samitin e Uellsit në 2014. Ato kanë të bëjnë me një program të gjerë për të rritur gatishmërinë e Aleancës për përmbushjen e tre detyrave të saj kryesore: mbrojtja kolektive, menaxhimi i krizave dhe siguria bashkëpunuese, si dhe përshtatja me mjedisin e përkeqësuar të sigurisë. Në fund të fundit, veprimet e Rusisë ndaj Ukrainës dhe paqëndrueshmëria në rritje në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut i shtynë udhëheqësit e NATO-s

të deklarojnë "një moment jashtëzakonisht të rëndësishëm për sigurinë Euro-Atlantike"[5].

Samiti i Varshavës është në funksion të përcaktimit nëse paketa e masave të dakordësuara në Uells i ka përmbushur pritshmëritë dhe të ofroj udhëzime të mëtejshme sipas nevojave. Shumë prej aleatëve e konsiderojnë gjendjen aktuale ushtarake të NATO-s si të pamjaftueshme. Në të njëjtën kohë, Aleanca nuk ka mjetet e nevojshme për të përmbushur ambiciet politike. Kjo çon në një mospërputhje themelore midis listës së dëshirave të ambicieve të aleatëve dhe burimeve ushtarake e financiare në dispozicion. Ky problem përforcohet edhe më tej nga kriza më e gjerë e integrimit evropian, e cila nuk lidhet më me sigurinë në vetvete, dhe që ndikon negativisht ne debatin rreth mbrojtjes. Pra, ruajtja e unitetit kolektiv përbën problemin më të rëndësishëm për të kapërcyer në Varshavë.

Plani i Gatishmërisë për Veprimi i NATO-s (RAP) ishte thelbi i Samitit të në Uellsit në vitin 2014 [6]. Ky plan përfshinte të ashtuquajturat masa të sigurisë si dhe një axhendë ambicioze për përshtatjen. E para fokusohej në krijimin e një prezence të vazhdueshme në krahun lindor të NATO-s nëpërmjet vendosjes së alternuar të aseteve tokësore, detare dhe ajrore. E fundit përfshin themelimin e një Task Force të Përbashkët

[5]Deklarata e Samitit të Uellsit (Neport: Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut [NATO], Shtator 5, 2014).

[6] Për diskutim të detajuar shikoni John R. Deni, "Trajektoret e Reja të NATO-s mbas Samitit të Uellsit" Parametri 44, nr. 3 (Vjeshtë 2014), 57–65; dhe John-Michael Arnold, "Plan-Veprimi i Gatshëm i NATO-s: Përfitimet Strategjike dhe Sfidat e Diskutueshme," Studimet Strategjike Trisemestrale 10, nr. 1 (Pranvere 2016), 74–105.

të Gatishmërisë Shumë të Lartë (*Very High Readiness Joint Task Force (VJTF*) dhe angazhimin për të rritur madhësinë dhe përgjegjshmërinë e Forcës së Reagimit të NATO-s.

VJTF kishte për qëllim krijimin e një "gracke të lëvizshme" që të shërbente si një "garanci e dislokueshme e solidaritetit të Aleancës", që mund të përforcohej me shpejtësi me forca të reja sipas nevojës[7]. Gjithashtu, axhenda e përshtatjes u fokusua në rishikimin e funksionimit të Aleancës në të gjitha aspektet e saj, duke përfshirë procedurat e vendimmarrjes, të komunikimit strategjik, si dhe mënyrat e përballjes me të ashtuquajturat kërcënime ushtarake hibride.

Shpejtësia me të cilën Aleanca mund të identifikojë dhe reagojë ndaj formave të ndryshme të agresionit përbën një çështje qendrore në këtë drejtim. Të gjitha më lart pritet të rezultojnë me një kosto. Prandaj, udhëheqësit e NATO-s ranë dakord të kthejnë mbrapsht tendencën për të zvogëluar buxhetin e mbrojtjes. Ky zotim për investimin për mbrojtjen përmbante një angazhim të fortë për të ndaluar çdo rënie në shpenzimet për mbrojtjen, si dhe një angazhim më të butë me qëllim rritjen e shpenzimeve të mbrojtjes drejt objektivit prej 2 % kur produkti i brendshëm bruto rritet. Së fundi, ministrat e mbrojtjes të NATO-s në qershor të vitit 2015 i ritheksuan këto vendime duke nxjerrë udhëzime të reja politike që rriti nivelin e ambicies në aspektin cilësor.

[7] Glatz dhe Zapfe, 4

Pavarësisht faktit se zbatimi i këtyre vendimeve ka vazhduar me intensitet, aleatë të ndryshëm ankohen se paketa e Uellsit është e pamjaftueshme. Pjesërisht, kjo lidhet me rritjen e ndërgjegjësimit që dislokimi dhe përforcimi i mëtejshëm i VJTF nuk mund të jetë aq i sigurt apo aq i shpejtë siç kërkohet.

Sfida e kundëraksesit/zonës së ndaluar (A2/AD) rreth Kaliningradit duket shumë e afërt në këtë aspekt[8]. Përkatësisht, Aleanca mbetet rrezikshmërisht e ndjeshme ndaj një skenari hipotetik të *coup de main* në rajonin e Baltikut[9]. Përveç këtij skenari më të rrezikshëm, shtetet baltike mund të jenë objektiv i përpjekjeve jo konvencionale destabilizuese që mund të rezultojnë në konflikte aksidentale[10]. Si vendi i mbajtjes së Samitit, Polonia udhëheq rrugën në advokimin për vendosjen e një prezence të përhershme të NATO-s përgjatë kufirit lindor[11].

Pra si duhet të jetë në detaje një qasje e "mbrojtjes së avancuar"?[12] A duhet që Aleanca të ndjekë shembullin e Rusisë që heq dorë nga Akti

[8] Stephan Frühling dhe Guillaume Lasconjarias, "NATO, A2/ AD dhe Sfida e Kaliningradit," Survival 58, nr: 2 (2016), 95–116.

[9] Krahaso, për shembull, David A. Shlapak dhe Michael . Johnson, Riforcimi i Parandalimit të NATO-s në Krahun Lindor: Provimi i Mbrojtjes në Baltik (Santa Monica, CA: RAND, 2016); dhe A. ess Mitchell, "Një Strategji e Re Baltike e Guximshme për NATO-në," The National Interest, Janar 6, 2016.

[10] Shiko Julianne Smith dhe Jerry Hendrix, Zgjidhja e Siguruar: Testimi i Sfidave të Mundshme në Sigurinë e Baltikut (Uashington, DC: Qendra per një Siguri të Re Amerikane, Prill 7, 2016).

[11] Shiko, për shembull, fjalet e Presidentit Polak Andrzej Duda në Këshillin e Atlantikut, Uashington, DC, Mars 30, 2016; krahaso Tomasz Paszeski, "A Mundet Polonia të Mbrojë Vetveten?" Survival 58, nr: 2 (2016), 117–134.

[12] John R. Deni, "Polonia Kërkon më Shumë Se Sa NATO Mund të Ofrojë," The National Interest, Shkurt 10, 2016.

Themelues NATO-Rusi i vitit 1997? Një veprim i tillë nënkupton angazhimin e forcave ushtarake që mund të jenë të padisponueshme për misione të tjera përgjatë një periudhe kohore të pacaktuar.

Gjithashtu, ministri i mbrojtjes së Gjermanisë ka theksuar tashmë se çdo prezencë e ardhshme do të mbetet e alternuar dhe në përputhje me detyrimet ekzistuese[13]. Megjithatë mungesa e oreksit në rritjen e mbrojtjes konvencionale, e kombinuar me vrullin e Rusisë, shton presionin për diskutimin e politikës bërthamore parandaluese të NATO-s.[14] Ndërsa supozimet mbi të cilat është bazuar Rishikimi i Qëndrimit për Parandalimin dhe Mbrojtjen i vitit 2012, padyshim nuk janë më të vlefshme, ripërtëritja e parandalimit bërthamor do të gjenerojë detyrimisht mjaft kundërshti të brendshme tek disa aleatë që marrin pjesë në shfrytëzimin e energjisë bërthamore, veçanërisht në Gjermani dhe Belgjikë.

Çështja e dytë më e madhe është se PGV drejtohet më shumë në drejtim të Lindjes, ku disa nga aleatët nuk janë dhe aq të interesuar, por të cilët janë më të shqetësuar nga paqëndrueshmëria përgjatë kufirit jugor të Aleancës.

Meqenëse flukset migratore po tejkalojnë kapacitetet administrative të

[13] Ursula Von der Leyen, "Fjalimi Kryesor i dhënë në Konferencen e GLOBSEC," Bratislavë, Ministria Gjermane e Mbrojtjes, Prill 15, 2015.

[14] Krahaso Franklin C. Miller, Përshtatja e Politikave Bërthamore të NATO-s: Një Program prej 5-Hapash (Uashington, DC: Këshilli Atlantik, Mars 23, 2016); dhe Karl-Heinz Kamp, "Mirësevini në Epokën e Tretë Bërthamore," The National Interest, Maj 2, 2016.

disa prej aleatëve deri në pikën e fundit dhe terroristët islamikë po korrin sukses në shënjestrimin e vendeve evropiane, shumë institucioneve të mbrojtjes aleate i kërkohet të kryejnë misione brenda vendit gjë e cila ka pasoja të rëndësishme në kushtet e gatishmërisë së forcës[15].

Shtete si Italia dhe Spanja, do të përpiqen shumë për të dakordësuar një strukturë për fqinjët jugorë. Roli i aleancës në projektimin e stabilitetit në vendet e tjera dhe zbutja e pasojave të konfliktit nuk ka gjasa të zvogëlohet. Të punuarit së bashku me partnerët do të jetë një element i rëndësishëm në axhendën e samitit. Gjithashtu nisma të tilla si ndërtimi i kapaciteteve mbrojtëse kërkon burime të konsiderueshme për të gjeneruar rezultatin e synuar.

Hendeku i madh ndërmjet ambicieve të kombinuara të aleatëve të veçantë dhe disponueshmëria e përgjithshme e burimeve financiare, materiale dhe burimeve njerëzore përbën një tjetër problem thelbësor.
Ndërsa për sfidat e sigurisë afër NATO-s, secili ka përgjigje logjike në lidhje me atë që është e nevojshme, bashkimi i forcave aleate janë të pamjaftueshme për të përmbushur të gjitha kërkesat, veçanërisht në qoftë se merren parasysh faktorët e gatishmërisë dhe të pakësimit të

[15] Si pasojë e sulmeve terroriste në Paris dhe Bruksel, për shembull, autoritetet franceze dhe belge u përgjigjen duke vendosur rreth 9 për qind dhe 16 për qind të forcave të tyre të tokës në operacionet e atdheut. Disa vende të tjera janë duke i bërë thirrje ushtrive te tyre për përmbushjen e detyrave të ngutshme në sigurinë e kufirit dhe menaxhimin e refugjatëve. Bundesehri-të i thuhet të siguroje afërisht 9.000 ushtarë për të ndihmuar dhe ndërmarrë refugjatet ne Gjermani. Shih "Thirrje për Bundesehr të Rishpërndajë Burimet nga Shqetësimi për Refugjatët tek Misionet e NATO-s," Deutsche Welle, Dhjetor 28, 2015.

forcave. Për këtë arsye mund të pritet se aleatët e ndryshëm do akuzojnë njëri-tjetrin se nuk kanë bërë mjaftueshëm. Ndërsa këta Aleatë në mënyrë të hapur shprehin përçmimin, angazhimin minimal si dhe rënien në shpenzimet e tyre të mbrojtjes (që është, Shqipëria, Belgjika, Bullgaria dhe Italia) do të përballen me presion të konsiderueshëm për të ndryshuar kursin, mbetet një realitet i pashmangshëm që shpenzimet e mbrojtjes të NATO-s janë shtyrë në fund të fundit me shumicë dërrmuese nga shtete më të mëdha anëtare [16].

Rritjet spektakolare në shpenzimet e mbrojtjes nga aleatë te tillë si Polonia, Letonia dhe Lituania nuk mund të zbusin ndjeshëm pasojat e stanjacionit buxhetor në Shtetet e Bashkuara dhe në Evropën Perëndimore. Rezultati përfundimtar i këtij konteksti financiar është se ajo do të mbetet e vështirë gjatë viteve të ardhshme që do ofrojë aftësitë e nevojshme për të përmbushur nivelin aktual të ambicies dhe mbështetjes së mbrojtjes aleate.

Në aspektin politik, aleatët evropianë do të përjetojnë një reagim te ftohtë të befasishëm kur të kuptojnë se shqetësimet e tyre gjithnjë e më te mprehta të sigurisë pjesërisht mund të mënjanohen nga solidariteti i Aleancës. Duke pasur parasysh se administrata të njëpasnjëshme amerikane janë ankuar në lidhje me nivelet gjithnjë e në rënie të shpenzimeve të mbrojtjes evropiane, kjo çështje ka një potencial të vërtetë për t'u bërë një "ditë transatlantike e llogarisë". Kjo perspektivë

[16] Buxhetet e kombinuara të mbrojtjes së Francës, Gjermanisë, Italisë, Mbretërisë së Bashkuar, dhe Shteteve të Bashkuara llogariten deri në më shumë se 90% të Aleancës në total.

është bërë me shumë gjasa tani që ndarja e barrës së NATO-s është bërë një temë në fushatën elektorale për President të SHBA-ve.

Frika evropiane mbi mbrojtjen e jashtme të NATO-s përforcohet nga kombinimi i krizave që ndikojnë procesin më të gjerë të integrimit evropian. Kolapsi i afërt i eurozonës dhe stresit të migrimit të shkaktuara në zonën Shengen e udhëtimit pa kufij kanë shkaktuar mosmarrëveshje të hidhura dhe akuza për shantazh politik mes evropianëve. Është e vështirë të mbivlerësohet shkalla në të cilën besimi politik në mesin e këtyre aleatëve ka rënë. Si në nivelin e liderëve politikë dhe të popullsive të tyre, ideja e solidaritetit në mesin e evropianëve është në pikëpyetje.

NATO si një organizatë nuk është imune nga këto zhvillime. Nga njëra anë, si Rusia dhe Shteti Islamik i Irakut dhe Levantit në mënyrë aktive kërkojnë të nxisin dhe të shfrytëzojnë përçarjen evropiane për avantazhin e tyre strategjik[17]. Në anën tjetër, nuk mund të përjashtohet që vendet aleate mund të angazhohen në hakmarrje diplomatike kundër politikave të njëri-tjetrit midis kornizave të ndryshme institucionale. Nocioni i disintegrimit evropian , nëse do të ndërtohej, nuk mund të ketë tjetër veçse pasojat më të thella për menaxhimin e Aleancës. Rritja e populizmit politik dhe euroskepticizmit forcon tendenca të tilla centrifugale. Kjo "sfidë nga përbrenda" mund të jetë aq e tmerrshme sa ato me të cilat NATO përballet në kufijtë e tij. Nuk është e vështirë për

[17] Shiko, për shembull, Sijbren de Jong, Konfuzo, Ndaj dhe Sundo— Si Rusia e Ndan Evropën, Policy Brief 2/2016 (Bruksel: Instituti për Studime Evropiane, Mars 2016).

të parë se si trazirat politike mund të rezultojnë në paralizë strategjike. Më 23 qershor 2016, Mbretëria e Bashkuar do të mbajë një referendum në se vendi duhet të mbetet anëtar i Bashkimit Evropian.

Shpërbërja e mundshme e organizatës simotër të NATO-s nuk mund të mos minojë unitetin perëndimor në mënyrën më të fshehtë të mundshme. Përveç kësaj, sanksionet ekonomike të BE-s kundër Rusisë përfundojnë më 31 korrik, 2016 (nëse se nuk zgjaten, pasi është vendim që kërkon unanimitet evropian).

Referendumi holandez në Marrëveshjen e Asociimit mes BE-s dhe Ukrainës tregon se sa e aftë është bërë Rusia në nxitjen e ndarjes përmes fushatave të synuara të disinformacionit.

Së fundmi, por jo nga rëndësia, polemikat e brendshme politike evropiane mbi tema të tilla si emigracioni apo çështjet ekonomike, mund të gërryejnë vendosmërinë e Aleancës dhe për këtë arsye përbën një dobësi kritike. Ndërsa Samiti i Uellsit u përshëndet gjerësisht si një pikë kthesë historike, axhenda për Varshavën duket e zymtë.

Me gjithë progresin e rëndësishëm e realizuar gjatë 18 muajve të fundit, dyshimet nëse PGV do të përmbushë objektivat e saj apo jo, janë përhapur gjerë. Dyshime të tilla mbi gatishmërinë ushtarake mund të trajtohen, por mbetet të shihet nëse marrëveshja mund të gjendet se si të ndahen kostot që kjo do të sjellë. Për më tepër, debati ushtarak është

ndikuar në masë të madhe nga një humbje e besimit në bashkëpunimin dhe unitetin evropian. Prandaj, sfida kryesore është: si mund të frenohet copëzimi politik dhe te mbrohet kohezioni i Aleancës?

3. Zgjerimi i debatit të sigurisë

Çdo konsensus kuptimplotë brenda Aleancës fillon me një vlerësim të përbashkët të mjedisit të sigurisë ndërkombëtare. Për fat të keq, shumë nga aleatët perceptojnë kërcënime të ndryshme. Kjo është kryesisht pasojë e pozitës së tyre gjeografike në kontinentin evropian.

Zgjedhja binare mes forcimit të mbrojtjes lindore të Aleancës, duke u kujdesur për fqinjët e saj jugorë, ndoshta përbën pikën më të madhe të fërkimit në drejtim të menaxhimit të Aleancës. Kjo pengesë mund të tejkalohet duke e zvogëluar dhe ju përqasur mjedisit të sigurisë nga 360 gradë. Edhe gjatë Luftës së Ftohtë, strategjia e NATO-s është informuar nga analiza të kujdesshme të kontekstit të sigurisë globale. Do të ishte qesharake të mos angazhohet në një diskutim të ngjashëm në ditët e sotme.

Vetëm nëse çdo aleat, duke përfshirë Shtetet e Bashkuara, parashtrojnë grupin e tyre të shqetësimeve, mund të gjendet një konsensus i balancuar. Debati “Lindje - Jug” është politikisht helmues, sepse nxit një frikë të braktisjes së aleatëve më të rrezikuar. Harta evropiane e mbrojtjes së modeleve të shpenzimeve për mbrojtjen ka dalë në dritë.

Në terma të përgjithshme, kthimi i valës së shpenzimeve të mbrojtjes është duke u përsëritur mbi kontinentin evropian nga lindja në perëndim dhe nga veriu në jug. Kjo krijon përshtypjen se disa aleatë vënë paratë aty ku është interesi i tyre, dhe jo ku është interesi i të tjerëve. Megjithatë, një perceptim i tillë lë jashtë konsideratat më të gjera politike dhe ekonomike.

Me kalimin e kohës, ndryshimi i trendit buxhetor do të ndihet në çdo cep dhe çarje të Aleancës. Por edhe kjo nuk do të kompensoj ekuilibrin themelor mes neneve 3 dhe 5 të Traktatit të Uashingtonit: vetë-ndihma individuale dhe ndihma reciproke shkojnë krah njëra-tjetrës. Anëtarësia e Aleancës nuk përjashton vendet nga përgjegjësia për të mbajtur mbrojtjen e tyre dhe të kontribuojnë në kauzën e përbashkët.

Për të arritur konsensus, është e domosdoshme që çdo aleat të artikulojë shqetësimet e veta të sigurisë. Kjo në mënyrë të pashmangshme do të thotë se fokusi në krahun lindor hollohet deri në një farë mase. Shqetësimet në lidhje me Veriun e lartë, të Atlantikut të Jugut, Sahel-in, apo terrorizmin e brendshëm janë të gjitha legjitime[18].

[18] Krahaso Duncan Depledge dhe James Rogers, "Sigurimi i një Veriu më të Gjere," RUSI Nesbrief 36, nr. 2 (2016), 19–20; Alexander Mattelaer, "Angazhimi në Rritje i BE-s në Sahel: Nga Ndihma Zhvillimi në Koordinim Ushtarak," në Fqinjët e Komshinjve të Bashkimit Evropian: Dimensionet Gjeopolitike dhe Diplomatike mbrapa Politikave të Fqinjësisë Evropiane, ed. Sieglinde Gstöhl dhe Eran Lannon (Surrey: Ashgate, 2015), 45–65; Bruno Cardoso Reis, "Brazili kundër NATO-s? Një Shikim Afatgjatë i Sigurisë Detare në Atlantik," në Forum Paper 23, Rezistimi ndaj NATO-s, Ngritja e Brazilit: Menaxhimi i Sigurisë Ndërkombëtare në një Rend Botëror të Rikalibruar, ed. Brooke A. Smith-indsor, (Romë: Kolegji Mbrojtes i NATO-s, 2015), 227–250.

Në çdo rast, këto shqetësime do të ndikojnë në njehsimin strategjik te bërë nga aleatët individualë. Përfshirja e elementeve të tillë në debatin e NATO-s jo vetëm që do të nxisë diskutim të sinqertë dhe mosmarrëveshje të rastit, por gjithashtu ajo do të bëjë diskutimin e vështirë për ndarjen e përgjegjësisë. Disa vende mund të kundërshtojnë një qasje të tillë 360° dhe të argumentojnë se Aleanca duhet të përqendrohet vetëm në mbrojtjen kolektive kundër Rusisë. Megjithatë, gjatë gjithë historisë së saj, NATO ka qenë gjithmonë një organizatë me shumë qëllime, dhe koncepti për t'u fokusuar kundër një çështjeje të vetme ka gjasa të gjejë mbështetje të gjerë[19].

Ribalancimi i SHBA-ve në rajonin e Azi-Paqësorit meriton një vend të rëndësishëm në këtë diskutim[20]. Strategjia e NATO-s nuk mund të injorojë faktin se Shtetet e Bashkuara kanë angazhimet globale të sigurisë që përfshijnë detyrime lidhur me Azinë Lindore. Ndërsa numri i forcave të SHBA-ve është sigurisht i fundmë, partnerët globale të tillë si Japonia dhe Republika e Koresë shtojnë vlerën reale të NATO-s duke kontribuar në operacionet dhe mbështetur pikëpamjen demokratike liberale të rendit botëror. Diskutimet ndërmjet NATO-s dhe partnerëve të tillë mund të ndihmojnë, për shembull, të hedhin më shumë dritë mbi logjikën e frenimit të zgjatur bërthamor.

[19] Shiko Alexander Mattelaer, "Funksioni i Heshtur i Aleancës: Roli i NATO-s si një Depo Shumëkombëshe e Ekspertizës Ushtarake,"ibid., 53–69.

[20] Për sfond të mëtejshëm të ribalancimit shiko Michael Green et al., Ribalanca Azi-Pacifik 2025: Mundësitë, Prezenca dhe Partneritetet (Uashington, DC: Qëndra për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare[CSIS], Janar 2016).

Përzgjedhja e ish Komandantit të Forcave Amerikane në Kore, Curtis MW. Scaparrotti, si Komandanti i Bashkuar Suprem në Evropë sugjeron se ndërvarësia mes forcave aziatike dhe evropiane është duke u bërë gjithnjë e më e dukshme. Është ende e mundur të gjendet një sintezë e gjerë e Aleancës që i vë të gjitha këto pikëpamje të ndryshme në një perspektivë.

Sfidat e sigurisë rajonale meritojnë analizë të kujdesshme, por ato marrin domethënien e tyre të plotë vetëm kur vihen në një kontekst global. Kjo e bën të qartë se Aleanca nuk mund të zgjedhë të përqendrohet ekskluzivisht në të dyja krahët jugor ose lindor, por do të duhet të përgatitet për trajtimin e sfidave të shumta në të njëjtën kohë.

Është e rëndësishme për të nxjerrë në pah dimensionin e kohës si një variabël i planifikimit: kërcënimi nga lindja mund të jetë i papritur dhe masiv ndërsa në jug është i detyruar të jetë i një intensiteti më të vogël, por më të qëndrueshëm. Të dy mund të rrezikohen nga ngjarjet në vende të tjera në botë, më së shumti të paparashikuara në të ardhmen, si në Detin e Kinës Jugore ose në Gadishullin Korean.

Përkatësisht, mbrojtja e avancuar e Aleancës në lindje duhet të jetë më e fuqishme, përpjekjet e saj për të vendosur stabilitetin në jug, dhe hapësira e forcave të saj rezervë, duhet të jenë mjaftueshëm fleksibël për t'u kujdesur për të papriturat kurdo dhe kudo që ato ndodhin. Në

një farë mase, gjithashtu këto sfida kërkojnë grupe të ndryshme të kapaciteteve dhe sugjerojnë ndarjen e nënkuptuar të punës.

Në shumë mënyra, kohët e fundit vendimet e ShBA-ve tregojnë rrugën përpara. Katërfishimi i financimit të Nismës Evropiane për Siguri në buxhetin fiskal të vitit 2017, përbën një sinjal të fortë se mbrojtja e NATO-s është duke u forcuar ndjeshëm. Më së shumti, kjo përfshin rotacionin e skuadrave të blinduara të brigadave ushtarake nga shkurti i 2017-ës e më tej[21]. Kjo do të çojë të gjithë praninë e ushtrisë së SHBA-ve në Evropë deri në tre brigada, dhe materiale të mjaftueshëm për të pajisur një të katërtën. Disa prej këtyre njësive (të tilla si Grupi Luftarak i Brigadës Ajrore 173 i pozicionuar në Viçenca të Italisë) janë rezervuar për forca të shumta.

Në të njëjtën kohë, mbështetja e SHBA-s në Francë dhe Belgjikë në adresimin e kërcënimeve terroriste nënvizon faktin se detyra të ndryshme mund të trajtohen në të njëjtën kohë. Vendosja e një shembulli të tillë përbën një bazë të fortë për t'u kërkuar aleatëve të marrin përsipër pjesën e tyre, duke ndërtuar një prezencë të avancuar dhe mbajtjen e rezervave të mjaftueshme për të ofruar mbështetje të shpejtë aty ku është e nevojshme.

Megjithatë, nuk mund të pritet që Shtetet e Bashkuara të vetme t'i përgjigjen ndryshimit të mjedisit të sigurisë në Evropë. Evropianët do

[21] EUCOM Shpall Planin Zbatues të Nismës së Risigurimit Evropian," EUCOM Live Blog, March 30, 2016

të duhet të kujdesen për fqinjët e tyre më të afërt, së pari në mënyrë që të lejojnë Shtetet e Bashkuara të përqendrohen në sigurimin e forcave rezervë dhe të kapaciteteve të sofistikuara dhe mundësuese.

E konfiguruar kështu, Aleanca mund të shtojë vlerën maksimale si një platformë e përbashkët për të siguruar koherencë të gjithë përpjekjeve të mbrojtjes të Aleatëve individualë. Natyrisht, kjo kërkon që vendet evropiane të investojnë burime të mjaftueshme financiare dhe të orientojnë zhvillimin e kapaciteteve të tyre të mbrojtjes në përputhje me rrethanat. Dy pjesët e mëposhtme trajtojnë se si mund të zhvillohen më tej këto synime.

4. Nxitja e presionit të vendeve ndër-evropiane për shpenzimet e mbrojtjes

Ekziston një traditë e gjatë transatlantike për Sekretarët Amerikanë të Mbrojtjes të qortojnë aleatët evropianë për shpenzim të pamjaftueshëm të burimeve për sigurinë dhe mbrojtjen[22]. Megjithatë, kur vendet individuale paraqesin kërkesat konkurruese për garantimin e sigurisë nga NATO, ky trend mund të zëvendësohet me evropianët që qortojnë njëri-tjetrin që nuk kanë bërë mjaftueshëm.

Në veçanti, kërkesa për të ruajtur nivelet e duhura të shpenzimeve të mbrojtjes mund të integrohet në kuadër të Semestrit Evropian, ciklit

[22] Shiko, për shembull, Robert Gates, "Reflektime në Statusin dhe të Ardhmen e Aleancës Transatlantike," Bruksel, Axhenda e Sigurisë dhe Mbrojtjes, Qershor 10, 2011.

vjetor të udhëzimeve të politikave makroekonomike dhe mbikëqyrjes së BE-s. Ndërkohë që Bashkimi Evropian nuk mund të zëvendësojë marrëdhëniet transatlantike të sigurisë, ai mund të ndihmojë në mobilizimin e solidaritetit mes evropianëve dhe futjen e përpjekjeve të tyre të mbrojtjes në një kuadër më të gjerë të politikave, veçanërisht vis-à-vis me të ashtuquajturat kërcënime hibride. Presionet e tilla të vendeve ndër -evropiane do të ndihmojnë të trajtohen edhe aspektet financiare të debatit për ndarjen e përgjegjësisë.

Vlerësimi i progresit të bërë drejt përmbushjes së objektivave të investimeve për mbrojtjen të vendosura në Samitin e Uellsit jep një pamje të përzier. Një aspekt pozitiv është fakti që shumica e aleatëve e kanë ndaluar në mënyrë efektive shkurtimin e shpenzimeve të tyre të mbrojtjes. Shumë prej tyre projektojnë rritjen e buxhetit në vitet e ardhshme, ose janë tashmë në procesin e zgjerimit të shpenzimeve të tyre të mbrojtjes dhe disa prej tyre në mënyrë të ndjeshme[23]. Megjithatë, në terma reale, buxhetet nga aleatët më të mëdhenj janë thelbësisht në stanjacion.

Parashikimet e ardhshme kanë tendencë të bazohen në parashikime ekonomike optimiste. Nuk po konsiderohet mirë mundësia që ekonomitë perëndimore mund të përballen me një recesion të ri në vitet e ardhshme. Gjithashtu, shumë aleatë i kanë shtyrë projektet për

[23] Alessandro Marrone, Olivier De France, dhe Daniele Fattibene, Buxhetet e Mbrojtjes dhe Bashkëpunimit në Evropë: Zhvillimet, Prirjet dhe Drejtuesit (Rome: Istituto Affari Internazionali, Janar 2016).

investime në vitet e fundit për të paguar për shpenzimet operative në Afganistan dhe gjetkë. Si rezultat i kësaj, ata po përballen tani me akumulimin e faturave për modernizimin e forcave. Efekti i 'përhapjes së valës' ndikon jo vetëm tek aleatët e vegjël, të tilla si vendet me flota ushtarake F-16, por edhe ato më të mëdha si Gjermania dhe Shtetet e Bashkuara[24].

Kjo do të thotë se edhe riinvestimi thelbësor për mbrojtjen nuk mund të përkthehet menjëherë në kapacitete shtesë, pasi shuma të mëdha janë konsumuar thjeshtë nga rigjenerimi i strukturave të forcave aktuale. Për përmbushjen e ambicies së Aleancës, hapësira e kapaciteteve duhet të bëhet më e specializuar, e gjerë dhe më e gatshme. Të gjitha më lart shpalosen përkundër një konteksti të rritjes së kërkesave për kapacitete për të përmbushur nivelin e ambicies së Aleancës. Si rezultat i kësaj, presioni mbi të gjithë aleatët për të shpenzuar më shumë dhe në mënyrë më të mençur do të rritet dhe do të vazhdojë.

Është interesante të vërehet se të gjithë aleatët që janë edhe anëtarë të BE-s kanë përqafuar një sistem shumëpalësh të koordinimit të politikave makroekonomike dhe mbikëqyrjes buxhetore që është i ndarë plotësisht nga nevojat e sigurisë kombëtare. Sipas sistemit të Semestrit Evropian, qeveritë kombëtare paraqesin buxhetin e tyre vjetor dhe programet e reformave ekonomike të tyre për shqyrtim në

[24] Për diskutime të efektit "bo ave," shiko Todd Harrison, Planet e Modernizimit të Mbrojtjes gjatë 2020: Adresimi i Bo ave (Uashington, DC: CSIS, 2016).

Komisionin Evropian[25]. Ky i fundit monitoron progresin drejt objektivave "Europe 2020" për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe jep rekomandime specifike për vendet për përmbushjen e atyre.

Për vendet e Eurozonës, ky proces përfshin edhe Komisionin Evropian në dhënien e opinioneve të vlerësimit mbi planet e dorëzuara të projekt-buxhetit. Ky mekanizëm mbikëqyrës mund të çojë në veprime korrigjuese dhe madje edhe të vendosë gjoba. Ndërkohë që Komisioni Evropian merr parasysh shpenzimet për mbrojtjen si zë në buxhetin kombëtar duke e vlerësuar në aspektin fiskal dhe nuk mund të akordojë ndonjë vlerë për këtë.

Fakti se sistemi i Semestrit Evropian është *de facto* indiferent ndaj sigurisë, ka provokuar tashmë mjaft kritika. Duke iu drejtuar të dyja dhomave të parlamentit, si pasojë e sulmeve terroriste të nëntorit 2015 në Paris, Presidenti francez François Hollande deklaroi se "pakti i sigurisë do të ketë përparësi ndaj paktit të stabilitetit[26]."

Në fakt, ai theksoi se shpenzimet shtesë për sigurinë dhe mbrojtjen duhet të përjashtohen nga objektivat e borxhit kombëtar të monitoruar nga Komisioni Evropian. Ndërsa ky lloj fleksibiliteti mund të justifikohet në raste të jashtëzakonshme, do të kishte më shumë kuptim

[25] Krahaso, për shembull, Zsolt Darvas dhe Álvaro Leandro, Koordinimi i Politikave Ekonomike në zonën e Euros nën Semestrin Evropian (Bruksel: Parlamenti Evropian, Komiteti i Marrëdhënieve Ekonomike dhe Monetare, Nëntor 2015).

[26] Fjalimi i Presidentit François Hollande para seancës të përbashkët të Parlamentit, Versajë, Nëntor 16, 2015.

që të përfshihen objektiva minimale për shpenzimet e mbrojtjes në sistemin e Semestrit Evropian.

Semestri Evropian

Semestri Evropian është cikli vjetor i koordinimit të politikave ekonomike, që ka për qëllim implementimin e rregullave dhe prioriteteve të BE. Fazat kryesore janë:

Nëntor: Komisioni Evropian nxjerr anketën vjetore të zhvillimit, që propozon prioritetet ekonomike të BE për vitin e ardhshëm dhe formulon opinione mbi draft planet buxhetore të qeverive kombëtare në zonën e euros.

Dhjetor–Janar: Vendet anëtare të BE miratojnë buxhetet kombëtare dhe së bashku japin rekomandime për zonën e euros si një e tërë.

Shkurt: Komisioni Evropian harton nga një raport kombëtar për secilin vend anëtar.

Mars: Krerët e shteteve dhe qeverive të BE miratojnë formalisht prioritetet ekonomike të bazuara në anketën vjetore të zhvillimit të komisionit.

Prill: Shtetet anëtare të BE-së paraqesin planet e tyre kombëtare për reformat ekonomike dhe të forcimit të financave publike.

Maj: Komisioni Evropian jep rekomandime të veçanta për secilin vend për politikat buxhetore, ekonomike dhe sociale.

Korrik: Krerët e shteteve dhe qeverive të BE i miratojnë këto rekomandime.

Shtator– Tetor: Qeveritë kombëtare në Eurozonë i paraqesin Komisionit Evropian projekt planet buxhetore për vitin e ardhshëm.

Gjatë gjithë vitit: Parlamenti Evropian angazhohet në dialogun me Komisionin Evropian për anketën vjetore të zhvillimit dhe rekomandimet e veçanta për secilin vend.

Ndonëse zbatimi i rekomandimeve të komisionit në nivel kombëtar është i ndryshëm, sistemi mundëson mbikëqyrjen e reformave ekonomike të ndërmarra nga vendet anëtare dhe përfshin një mekanizëm sanksionues për ata që marrin masa korrigjuese të përshtatshme. Edhe pse i jep vendeve anëtare udhëzime buxhetore që përfshijnë të gjitha funksionet qeveritare, aktualisht nevoja për të investuar në mbrojtje nuk është objekt diskutimi. Ndaj miratimi i një "përqindje të PBB" për mbrojtjen do t'i jepte një dimension makroekonomik shpenzimeve të mbrojtjes në kuadër të sistemit Semestri Evropian.

Nëse zotimit të NATO-s për investime për mbrojtjen i jepet edhe një kuptim real nga ana e planifikuesve të buxhetit, logjikisht kjo do ta çojë atë përpara. Konsolidimi buxhetor dhe nivelet e duhura të shpenzimeve të mbrojtjes duhet të shkojnë paralelisht; nuk duhet të shërbejnë si një perde tymi për të injoruar tjetrin. Integrimi i disa zotimeve për investimet në mbrojtje në sistemin e Semestrit Evropian do të sjelli përfitime të rëndësishme.

Para së gjithash, kjo do të shmangte kontradiktën e mundshme midis objektivave të pakoordinuara buxhetore të vendosura nga NATO dhe BE. Gjithashtu, ky zotim i evropianizuar i investimit në mbrojte do të ishte më kuptimplotë, sepse kjo do të përfshihej në procesin e përgjithshëm buxhetor të vendeve evropiane së bashku me një mekanizëm sanksionues mbikombëtar. Integrimi i disa zotimeve për investimet në mbrojtje do t'i jepte sistemit të Semestrit Evropian legjitimitet më të madh me përfshirjen e objektivave të sigurisë, gjë që është një funksion kyç i qeverisë.

Më thelbësisht, kjo do t'i jepte një pamje më të pranuar procedurale për idenë e solidaritetit ndër-evropian në fushën e sigurisë. Një Semestër Evropian më i prirur drejt mbrojtjes do të kanalizonte në një drejtim më produktiv debatin që tashmë ka filluar ndërmjet evropianëve. Kështu, kjo do të balanconte forcat centrifugale mbi diskutimet buxhetore të BE-s që janë krijuar në të kaluarën.

Sigurisht, mund të ketë pasur shumë kundërshtime për këtë propozim të vendosjes së objektivave për mbrojtjen në Semestrin Evropian. Vendet anëtare të BE që janë neutrale mund të kundërshtojnë futjen e objektivave zyrtare të shpenzimeve për mbrojtjen në kuadër të NATO-s në kontekstin e BE-s.

Edhe vendet aleate mund të mendohen dy herë për zhvendosjen e asaj që disa e konsiderojnë si udhëzime të buta të NATO-s në objektiva të detyrueshme për shpenzimet e mbrojtjes të BE-s. Gjermania në veçanti do të mbetet e vendosur se disiplina fiskale nuk duhet të lihet jashtë. Kombinimi i këtyre faktorëve mund të çojë në një dobësim evropian, të asaj që është rënë dakord në Samitin e Uellsit. Në të njëjtën kohë, është pikërisht lidhja e fushave të ndryshme të politikave që bën të mundur marrëveshjet e mëdha.

Ndërkohë që supozohet se vendet pranojnë vetëm objektiva më pak ambiciozë të shpenzimeve për mbrojtjes kur ato bëhen vërtet të detyrueshme, sistemi i Semestrit Evropian mund të shtojë realizëm dhe të kontribuojë në efikasitetin e shpenzimeve. Kjo mund të ofrojë stimuj më të mëdhenj për rritjen e bashkëpunimit shumëkombësh, për shembull, në fushën e prokurimit për mbrojtjen. Më e rëndësishmja, kjo mund të ndihmoj në mbështetjen e shpenzimeve për mbrojtjen, në rast të një rënie ekonomike në të ardhmen, duke përfshirë konsideratat për sigurinë në debatin mbi politikën makroekonomike.

Komisioni Evropian dhe Përfaqësuesja e Lartë e BE-s për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë kanë sinjalizuar gatishmërinë e tyre për thellimin e bashkëpunimit me NATO-n dhe për t'u përfshirë më tepër në çështjet e sigurisë. Komunikimi i tyre i përbashkët i kohëve të fundit për përballimin e kërcënimeve hibride tregon ndërgjegjësim në rritje në lidhje me sfidat e sigurisë në fqinjët e BE-s dhe bën thirrje për intensifikimin e bashkëpunimit NATO-BE në fusha të ndryshme duke filluar nga ndërgjegjësimi i situatës dhe komunikimi strategjik për parandalimin e krizave dhe përgjigjen ndaj tyre[27].

Nocioni i kërcënimeve hibride mund të shërbejë si një mjet për zhbllokimin e mbështetjes së BE-s në një gamë të gjerë fushash që kontribuojnë në përmirësimin e mbrojtjes kolektive. Kjo mund të përfshijë mobilizimin e burimeve të konsiderueshme financiare për të modernizuar infrastrukturën e transportit, mbrojtjes, si dhe sistemeve të furnizimeve Evropiane[28]. Duke pasur parasysh se Samiti i Varshavës mund të vijë me një deklaratë të përbashkët NATO-BE, mund të identifikohen disa mundësi për bashkëpunim më të thellë. Duke shqyrtuar mënyrat në të cilat mekanizmat koordinues të politikave buxhetore NATO-BE do të mund të sinkronizohen, do të dalin në pah si një aspekt premtues për realizimin e një progresi të madh.

[27] Strukturë e Përbashkët mbi Përgjigjen ndaj Kërcënimeve: Një Përgjigje e Bashkimit Evropian (Bruksel: Komisioni Evropian, Prill 6, 2016).

[28] Daniel Fiott, "Modernizimi i Infrastrukturës Mbrojtëse të NATO-s me Fondet e BE-s," Survival 58, nr. 2 (2016), 77–94.

5. Drejt Pozicionimit Plotësues të Forcave

Kohezioni i NATO-s mbetet në mënyrë kritike i varur në angazhimin e tij kolektiv të mbrojtjes. Për fat të keq, hendeku i pranishëm mes burimeve në dispozicion dhe kërkesave ushtarake hedh dyshime mbi besueshmërinë e mbrojtjes të NATO-s. Pasi ky hendek në rritje është rezultat i të dyjave, si rritja e nivelit të kërcënimit dhe bjerrjes së vazhduar të shumë ushtrive aleate, do të ishte e mungesë pjekurie të supozohej se rikthimi i shpenzimeve të mbrojtjes do të jetë e mjaftueshme në trajtimin e problemit në afat shkurtër-mesëm[29].

Planifikuesit e mbrojtjes së përbashkët në këtë mënyrë do të mbeten nën presion për të mbështetur sjelljen parandaluese të NATO-s me burime të pamjaftueshme. Samiti i Varshavës mund të bëj thirrje për të trajtuar këtë çështje përmes rritjes së bashkëpunimit shumëkombësh, avancimeve teknologjike dhe përshtatjes institucionale. Megjithatë, në fund, komandantëve të NATO-s do të duhet t'u jepen mundësi reale. Nën tension, NATO mund të ketë nevojë t'i rikthehet ndarjes së qartë të punës në kuptimin se çfarë armatimesh dhe kapacitetesh ofron secili Aleat si dhe vendeve ku i ofron. Për të qenë e mundur kjo, institucionet e mbrojtjes evropiane duhet të shkojnë në drejtim të zhvillimit të strukturave plotësuese të forcës. Këto mund të jenë të drejtuara drejt

[29] Krahaso Claudia Major dhe Christian Mölling, Për një "Realizëm të Ri" në Mbrojtjen Evropiane: Pesë Sfidat Kryesore që Duhet të Adresoje Strategjia e Mbrojtjes Evropiane, Policy Brief Nr. 117 (Uashington, DC: Fondi Marshall i Shteteve te Bashkuara në Gjermani, Prill 2016).

zonave rajonale të përgjegjësisë që përputhen me interesat kombëtare të vendeve të përfshira.

Aktualisht, kapacitetet ushtarake në dispozicion të NATO-s nuk mjaftojnë në lidhje me atë që kërkohet nëse një skenar mbrojtjeje materializohet[30]. Gjatë viteve të fundit, forcat e armatosura të Rusisë janë trajnuar dhe kanë mprehur kapacitetet e tyre për kryerjen e operacioneve ushtarake në shkallë të gjerë[31].

Për të pasur një parandalim konvencional në vend, analistët sugjerojnë se NATO duhet të jetë në gjendje të ngrejë afërsisht 13 brigada në shtetet baltike për të penguar agresionin rus (bazuar në një raport 1: 3 proporcion force)[32]. Edhe kur shtohen ato forca të dislokuara në grup dhe disponohen shpejt, si pasojë e forcave, numra të tilla trupash nuk është e lehtë të sigurohen. Për më tepër, llogaritje të tilla sasiore bëjnë abstraksion të avantazheve gjeografike dhe infrastrukturore të cilat Rusia mund t'i shfrytëzojë, p.sh., duke përdorur taktikat A2 / AD.

Për më tepër, Rusia nuk është i vetmi aktor që paraqet një kërcënim për Aleancën, disa burime duhet të gjenden pashmangshmrisht diku tjetër. Për shembull, është e vështirë të parashikohet se si NATO mund të

[30] Krahaso David A. Schlapak dhe Michael . Johnson, "Outnumbered, Outranged, and Outgunned: Si Rusia Mposht NATO-në," ar on the Rocks, Prill 21, 2016.

[31] Johan Norberg, Trajnim për Luftë: Aksionet Kryesore Ushtarake të Rusisë 2011–2014 (Stokholm: Agjensia Suedeze e Hulmutimit të Mbrojtjes, 2015); Andre Monaghan, "Lufta' në Betejën Hibride të Rusisë,'" Parametër 45, nr. 4 (Dimër 2015–2016), 65–74.

[32] Kathleen H. Hicks dhe Heather A. Conley, Vlerësimi i Forcës Ushtarake të ShBA-ve në Evropë: Fazë I Raport (Uashington, DC: CSIS, 2016).

dështojë për të akomoduar kërkesën e Libisë për ndihmë. E fundit por jo më pak e rëndësishme, disa vende kanë angazhime dhe përgjegjësi kombëtare të cilat e bëjnë të pamundur vendosjen e të gjitha forcave të tyre në dispozicion të Aleancës. Operacionet kombëtare për t'u marrë me sigurinë e brendshme dhe menaxhimin e refugjatëve përvijohen veçanërisht në këtë drejtim. Për këtë arsye, hapësira e kombinuar e forcave në dispozicion të Aleancës është e pamjaftueshme në aspektin e gatishmërisë dhe madje mund të mungojnë numrat në shkallë absolute nëse përballet me perspektivën e përkimeve ushtarake.

Pyetja më e vështirë për planifikuesit e mbrojtjes të NATO-s është se si të bindin aleatët individuale për të mbushur hapësirën e kërkuar të forcave në mënyrën më efikase të mundshme. Në vitet e fundit, Aleanca është përpjekur të trajtojë mungesën e vazhdueshme të kapaciteteve si pasojë e përvojës operacionale.

Në mënyrë të ngjashme, pritshmëria e përhapur është se intensifikimi i bashkëpunimit shumëkombësh do të kompensoj ndikimin e reduktimit të forcave kombëtare. Kjo tregoi se sistemi i planifikimit të mbrojtjes mbas Luftës së Ftohtë, më së shumti drejt operacioneve reaguese ndaj krizave, dështoi në mbajtjen e ushtrive të bashkuara e të afta për të ardhmen. Pasi mbrojtja kolektive është kthyer në plan të parë, cështja që shtrohet është nëse ndarja e punës ushtarake brenda Aleancës duhet të rishikohet.

Gjatë Luftës së Ftohtë, Aleatët Kontinentalë të Evropës ishin të ngarkuar për sigurimin e thelbit të forcave tokësore dhe mbështetjen taktike ajrore, kurse sigurimi i ajrit dhe vijave detare të komunikimit ishin përgjegjësi e Shteteve të Bashkuara dhe Mbretërisë së Bashkuar. Përmes masave të ombrellës bërthamore, Shtetet e Bashkuara vepruan si agjenci siguruese e sistemit të mbrojtjes kolektive, të gatshme të rrezikonin sigurinë e tyre kombëtare në emër të aleatëve. Kjo qëndron në kontrast të plotë me prirjen që është krijuar mbas Luftës së Ftohtë.

Gjatë dy dekadave të fundit, ushtritë evropiane u përpoqën të zhvillojnë më ngadalë mundësitë e ekspeditave siç ishin të nevojshme për operacionet e stabilizimit në ish-Jugosllavi, Afganistan dhe vende të tjera. Aleanca u angazhua në nocionin e planifikimit të bazuar në mundësitë, e cila e hoqi planifikimin e forcës nga kërcënimet gjeo-politike specifike. Si rezultat i kësaj, Aleatët individualë zakonisht u përpoqën të ndiqnin interesin kombëtar në vendet që iu caktuan.

Një qasje e re do t'i bashkojë të dyja këto përvoja historike. Është gjithnjë e më e qartë se shtetet e vijës së frontit të Aleancës duhet të zhvendosin fokusin e planeve të tyre kombëtare të mbrojtjes dhe strukturave përkatëse të forcës. Shtetet baltike, për shembull, duhet të kalojnë nga të ekspozuara në forca të mekanizuara. Në mënyrë të ngjashme, Polonia mund të fokusohet në kombinimin e forcave lokale

të mbrojtjes me aftësitë gjurmuese të sulmit dhe mjeteve parandaluese.[33]

Një vend si Italia, nga ana tjetër, natyrshëm do të duhet të përqendrojë përpjekjet e saj në pellgun Euro-Mesdhetar dhe vendosjen e strukturës së forcës së saj për menaxhimin e krizave kryesore dhe përpjekjeve të bashkëpunimit të sigurisë aty[34]. Pamja që rezulton nga e gjitha kjo është se këto shtete që janë afër kërcënimeve të ndryshme me të cilat përballet Aleanca, do të duhet të përgatisin vetveten të jenë reaguesit e parë. Ata do ta bëjnë këtë nga nevoja absolute që lind nga vetë-ndihma. Nga ana tjetër, aleatët që janë gjeografikisht më pak të ekspozuar duhet të angazhohen për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e këtyre kapaciteteve që nevojiten të ofrojnë ndihmesë efektive për shtetet në nevojë.

Praktikisht kjo do të thotë se boshti franko-gjerman ofron shtyllën e brendshme për forcimin e mbrojtjes se Evropës, respektivisht në jug dhe në lindje. Duke u bazuar në kapacitetet e saj të ekspeditës qendër-detare, Mbretëria e Bashkuar mund të mbajë një qëndrim fleksibël të gatshëm për të ndihmuar aty ku është e nevojshme. Si gjithmonë, Shtetet e Bashkuara vazhdojnë rolin e tyre si agjenci siguruese të sistemit të Aleancës dhe ofrues të atyre kapaciteteve që janë jashtë mundësive për t'u arritur nga aleatët individualisht.

[33] Tomasz Szatkoski, "Polonia," me Aleancë në Rrezik (Uashington, DC: Keshilli Atlantik), 23–26.

[34] Andrea Gilli, Alessandro R. Ungaro, dhe Alessandro Marrone, "Letra e Bardhë Italiane për Mbrojtjen dhe Sigurinë Ndërkombëtare," RUSI Journal 160, nr. 6 (Dhjetor 2015), 34–41.

Një ndarje e tillë e punës e organizuar rreth *"compass rose"* që Aleanca mbart në emblemën e saj do të qartësojë se çfarë pritet nga çdo aleat. Ajo gjithashtu rrjetëzon mirë ambiciet e politikës së jashtme të vendeve të përfshira. Shpërndarja e detyrave ushtarake në bazë të orientimit rajonal dhe afërsive do të ndihmojë për të siguruar mbështetjen e brendshme për të forcuar përpjekjet kombëtare të mbrojtjes. Ky është një argument kyç për të luftuar kundërshtimin e parashikuar se rajonalizimi rrezikon çimentimin e copëzimit të Aleancës.

Ndërkohë, një ndarje e tillë e punës në një farë mase dobëson nocionin "të gjithë për një", asaj me shumë gjasa do t'i kërkohen sakrifica financiare dhe materiale politikisht të pranueshme. Si e tillë, vlera e shtuar e Aleancës duhet të gjendet në koherencën e përgjithshme që mund të sjellë nga planet e ndryshme rajonale dhe përpjekjet kombëtare që përndryshe do të ndahen pa koordinimin e kërkuar.

Nëpërmjet përpjekjeve të saj të zakonshme të financimit dhe të standardizimit, Aleanca mund të rrisë strukturën dërrmuese të mundësive dhe kapaciteteve funksionale që të përfitojnë të gjitha vendet në të njëjtën kohë, si një strukturë të integruar të komandës. Riorganizimi dhe lehtësimi i përpjekjeve që të gjitha vendet të angazhohen për arsyet e tyre drejt së mirës së përbashkët, a nuk është kjo arsyeja pse ngrihet një aleancë mbi të gjitha?

6. Përfundime

Në prag të Samitit të Varshavës, NATO ka nevojë për një përpjekje të vazhdueshme për ndërtimin e perceptimeve të përbashkëta rreth kërcënimeve, konsensus në lidhje me nevojat për investime, si dhe një shpërndarje të detyrave dhe përgjegjësive ushtarake. Rrjedhja e vazhdueshme e lajmeve shqetësuese që vijnë nga fqinjët e paqëndrueshëm të NATO-s tregon se një përpjekje e tillë do të duhet të ruhet për të ardhmen.

Axhendat e Samitit kanë tendencën që të prishen nga ngjarjet, dhe askush nuk është shërbyer duke vendosur shpresa të mëdha që nuk mund të përmbushen. Ajo çka do t'i shërbente më mirë Aleancës është një angazhim i durueshëm dhe shikimi përpara edhe në kushte të pafavorshme dhe në të gjitha nivelet e qeverisjes. Edhe pa ndonjë dramë të papritur, diskutimet në Varshavë do të jenë mjaft të vështira.

Në të njëjtën kohë, çdo krizë paraqet grupin e vet të mundësive, nëse ajo është menaxhuar mirë. Për herë të parë në një gjenerate, ekziston perspektiva e një prirje për ndryshim real të shpenzimeve të mbrojtjes evropiane. Kjo mund të ndihmojë që të vihet mbrojtja e NATO-s në një bazë më të qëndrueshme dhe të përmbushë pritshmëritë të evropianëve për t'u bërë partnerë më të besueshëm të sigurisë, si në zonën e tyre dhe më gjerë. Nga ana tjetër, kjo ofron një dritare të veçantë për ringjalljen

e rendit më të gjerë perëndimor të udhëhequr globalisht që po ndihet nën presion nga fuqitë autoritare[35]. Ajo që është në rrezik është jo vetëm axhenda e NATO-s, por edhe e ardhmja e botës së lirë.

Prosperiteti ekonomik dhe i sigurisë duhet të shkojnë dorë për dore. Të gjitha trazirat që rëndojnë mbi kontinentin evropian të paktën kanë shërbyer si një kujtesë se asnjëra nuk mund të merret si e mirëqenë. Si rezultat, mbështetja e brendshme për rregullimin e politikave të së kaluarës është në rritje. Të gjitha këto zhvillime janë të mirëpritura për aq kohë sa ato janë të kanalizuara në një drejtim koherent që reflekton interesat e të gjithë aleatëve.

Gjatë gjithë historisë së saj, NATO ka qenë në gjendje të kapërcej sfida të mëdha. Arritja e unitetit nuk ka qenë kurrë e lehtë. Megjithatë, nuk ka qenë asnjëherë e pamundur të sulmohej marrëveshja e madhe në lidhje me atë se çfarë duhet të behej. Samiti i Varshavës përbën një mundësi për të vazhduar këtë traditë. Kalkulimi i një pakete kompromisi midis vendeve më të mëdha, dhe zgjerimi gradual i këtij konsensusi për të përfshirë të gjithë 28 aleatët, është mënyra më pragmatike për të ecur para. Rindërtimi i gatishmërisë ushtarake të NATO-s për të realizuar objektivat politike të dakordësuara do të marrë kohë dhe përpjekje, por gjithsesi është duke u bërë progres. Si gjithmonë, duhet një kohë e gjatë për të treguar pak guxim.

[35] Jeffrey Gedmin, "Perëndimi në Krizë: Fundi i Evropës apo Rinovim Transatlantik?" War on the Rocks, Maj 5, 2016.

Bibliografia

"EUCOM Announces European Reassurance Initiative Implementation Plan," EUCOM Live Blog, March 30, 2016.

A. Wess Mitchell, "A Bold Ne Baltic Strategy for NATO," The National Interest, January 6, 2016.

Alessandro Marrone, Olivier De France, and Daniele Fattibene, Defence Budgets and Cooperation in Europe: Developments, Trends and Drivers (Rome: Istituto Affari Internazionali, January 2016).

Alexander Mattelaer, "The EU's Groing Engagement in the Sahel: From Development Aid to Military Coordination," in The Neighbours of the European Union's Neighbours: Diplomatic and Geopolitical Dimensions beyond the European Neighbourhood Policy, ed. Sieglinde Gstöhl and Eran Lannon (Surrey: Ashgate, 2015), 45–65.

Alexander Mattelaer, "The Silent Function of the Alliance: NATO's Role as a Multilateral Repository of Military Expertise," ibid., 53–69.

Andre Monaghan, "The 'war' in Russia's 'Hybrid Warfare,'" Parameters 45, no. 4 (inter 2015–2016), 65–74.

Andrea Gilli, Alessandro R. Ungaro, and Alessandro Marrone, "The Italian hite Paper for International Security and Defence," RUSI Journal 160, no. 6 (December 2015), 34–41.

Bruno Cardoso Reis, “Brazil versus NATO? A Long-term View of Maritime Security in the Atlantic,” in Forum Paper 23, Enduring NATO, Rising Brazil: Managing International Security in a Recalibrating Global Order, ed. Brooke A. Smith-windsor, (Rome: NATO Defense College, 2015), 227–250.

Claudia Major and Christian Mölling, For a “New Realism” in European Defense: The Five Key Challenges an EU Defense Strategy Should Address, Policy Brief No. 117 (Washington, DC: German Marshall Fund of the United States, April 2016).

Daniel Fiott, “Modernising NATO’s Defence Infrastructure with EU Funds,” Survival 58, no. 2 (2016), 77–94.

David A. Schlapak and Michael . Johnson, “Outnumbered, Outranged, and Outgunned: How Russia Defeats NATO,” ar on the Rocks, April 21, 2016.

David A. Shlapak and Michael . Johnson, Reinforcing Deterrence on NATO’s Eastern Flank: Wargaming the Defense of the Baltics (Santa Monica, CA: RAND, 2016).

Duncan Depledge and James Rogers, “Securing the wider North,” RUSI Nesbrief 36, no. 2 (2016), 19–20.

Franklin C. Miller, Adjusting NATO’s Nuclear Policies: A Five Step Program (Washington, DC: Atlantic Council, March 23, 2016);

Hans Binnendijk, Daniel SË. Hamilton, and Charles L. Barry, Alliance Revitalized: NATO for a New Era (Washington, DC: Center for Transatlantic Relations, April 2016).

Jeffrey Gedmin, “The est in Crisis: The Demise of Europe or Transatlantic Renewal?” ar on the Rocks, May 5, 2016.

Job C. Henning and Douglas A. Ollivant, “Radically Rethinking NATO and the Future of European Security,” ar on the Rocks, March 24, 2016.

Johan Norberg, Training to Fight: Russia’s Major Military Exercises 2011–2014 (Stockholm: Swedish Defence Research Agency, 2015).

John R. Deni, “NATO’s Ne Trajectories after the ales Summit,” Parameters 44, no. 3 (Autumn 2014), 57–65.

John R. Deni, “Poland ants More Than NATO Can Give,” The National Interest, February 10, 2016.

John-Michael Arnold, “NATO’s Readiness Action Plan: Strategic Benefits and Outstanding Challenges,” Strategic Studies Quarterly 10, no. 1 (Spring 2016), 74–105.

Joint Frameork on Countering Hybrid Threats: A European Union Response (Brussels: European Commission, April 6, 2016).

Julianne Smith and Jerry Hendrix, Assured Resolve: Testing Possible Challenges to Baltic Security (Washington, DC: Center for a New American Security, April 7, 2016).

Karl-Heinz Kamp, “elcome to the Third Nuclear Age,” The National Interest, May 2, 2016.

Karl-Heinz-Kamp, The Agenda of the NATO Summit in arsa (Berlin: Bundesakademie für Sicherheitspolitik, 2015).

Kathleen H. Hicks and Heather A. Conley, Evaluating Future U.SË. Army Force Posture in Europe: Phase I Report (Washington, DC: CSIS, 2016).

Michael Green et al., Asia-Pacific Rebalance 2025: Capabilities, Presence, and Partner ships (Washington, DC: Center for Strategic and International Studies [CSIS], January 2016).

Michal Baranoski and Bruno Lété, NATO in a orld of Disorder: Making the Alliance Ready for arsa (Washington, DC: German Marshall Fund of the United States, March 2016).

Rainer L. Glatz and Martin Zapfe, NATO Defence Planning between ales and arsa: Politico-military Challenges of a Credible Assurance against Russia (Berlin: Stiftung issenschaft und Politik, January 2016)

Robert Gates, "Reflections on the Status and Future of the Transatlantic Alliance," Brussels, Security and Defence Agenda, June 10, 2011.

Sijbren de Jong, Confuse, Divide and Rule— Ho Russia Drives Europe Apart, Policy Brief 2/2016 (Brussels: Institute for European Studies, March 2016).

Speech by President François Hollande before a joint session of Parliament, Versailles, November 16, 2015.

Stephan Frühling and Guillaume Lasconjarias, "NATO, A2/ AD and the Kaliningrad Challenge," Survival 58, no. 2 (2016), 95–116.

Todd Harrison, Defense Modernization Plans through the 2020s: Addressing the Bow wave (Washington, DC: CSIS, 2016).

Tomasz Paszeski, “Can Poland Defend Itself?” Survival 58, no. 2 (2016), 117–134.

Tomasz Szatkoski, “Poland,” in Alliance at Risk (Washington, DC: Atlantic Council), 23–26.

Trine Flockhart, An Agenda for NATO’s 2016 arsa Summit: Back to Basics or Just Backards? (Copenhagen: Danish Institute for International Studies, August 2015).

Ursula Von der Leyen, “Keynote Speech Delivered at the GLOBSEC Conference,” Bratislava, German Ministry of Defense, April 15, 2015.

Wales Summit Declaration (Newport: North Atlantic Treaty Organization [NATO], September 5, 2014).

Zsolt Darvas and Álvaro Leandro, Economic Policy Coordination in the Euro Area under the European Semester (Brussels: European Parliament, Economic and Monetary Affairs Committee, November 2015).

A ËSHTË NATO GATI TË NDËRMARRË NJË HAP VENDIMTAR NË DREJTIM TË MBROJTJES KIBERNETIKE?

Matthijs Veenendaal; Kadri Kaska; Pascal Brangetto

1. Abstrakt

Në prill të vitit 2016, Robert Work, Sekretari i Mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara deklaroi "ne po hedhim bomba kibernetike" mbi ISIS.[1] Edhe pse në mënyrë retorike, kjo deklaratë demonstron se kapacitetet kibernetike shihen si armë tashmë. Megjithëse shumë gjëra janë të paqarta në lidhje me të ardhmen kibernetike si një fushë për operacione ushtarake, është përtej cdo dyshimi se kapacitetet kibernetike mund të kryejnë sulme që mund të shkaktojnë vdekje dhe shkatërrim.

Duke qenë se forcat e armatosura moderne janë të varura nga teknologjia dixhitale, është legjitime të pritet se NATO do të përshtatet me këtë realitet të ri. Që prej vitit 2002 NATO ka investuar shumë për të përmirësuar mbrojtjen e rrjeteve të saj. Sidoqoftë NATO ka treguar shumë pak prirje që të tërhiqet qartësisht nga qëndrimi aktual i mbrojtjes kibernetike. Në nivelin politik, Aleatët mbeten të rezervuar kur vjen puna për të diskutuar opsionet e përdorimit të ushtrisë

[1] David Sanger, 'U.SË. Cyberattacks Target ISIS in a New Line of Combat', The New York Times, April 24 2016. http://www.nytimes.com/2016/04/25/us/politics/us-directs-cyberweapons-at-isis-for-first-time. html?_r=0

(kapaciteteve ofensive) në axhendën e NATO-s. Për shumë prej tyre, operacionet kibernetike janë përgjithësisht akoma territor i paeksploruar, në të cilën ka konfuzion me tepri. Për më tepër, Aleatët që kanë investuar fuqishëm në kapacitetet kibernetike, shqetësohen se të tjerët mund t'i përfitojnë ato edhe pa bërë një investim të vetëm. Prandaj Aleatët janë të rezervuar për t'u përfshirë në ndonjë diskutim të frytshëm në lidhje me pozicionin dhe rolin e mundësive kibernetike në operacionet ushtarake brenda Aleancës.

Në mënyrë që të arrijmë një qëndrim më të matur dhe realist të qëndrimeve mbrojtëse kibernetike, Aleanca duhet të adresojë dy çështje të rëndësishme. Fillimisht, ajo duhet ta bëjë të qartë se mbrojtja e rrjetit nuk nënkupton mbrojtjen kolektive në hapësirën kibernetike. Së dyti, duke qenë se NATO pranon zbatueshmërinë e mbrojtjes kolektive në hapësirën kibernetike, Aleatët duhet të zhvillojnë një gamë të gjerë kapacitetesh ushtarake për të mbrojtur Aleancën dhe interesat e saj.

2. Përshtatja e reagimit ndaj sulmeve kibernetike

NATO ka deklaruar se nëse sulmohet nëpërmjet hapësirës kibernetike, Këshilli i Atlantikut të Veriut do të vendosë për zbatimin e nentit 5, rast pas rasti, që do të thotë abstenim nga gjykimi paraprak i çdo reagimi dhe kështu të ruhet fleksibiliteti në zgjedhjen e kursit të veprimit që mund apo nuk mund të merret.[2] Sidoqoftë, për sa kohë që politikat e

[2] Steve Ranger, 'NATO updates cyber defence policy as digital attacks become a standard part of conflict'. ZDNet, June 30, 2014. http://www.zdnet.com/article/nato-updates-cyber-defence-policy-

mbrojtjes kibernetike të NATO-s mbeten të fokusuara dhe interpretohen nga perspektiva e mbrojtjes së rrjetit, fleksibiliteti i parashikuar nuk do të përfshijë një kurs veprimi që përfshin përdorimin e kapaciteteve ushtarake kibernetike. Pyetja që ngrihet është "nëse ndonjë forcë ushtarake mund të pretendojë në mënyrë të besueshme se ka avancuar kapacitetet nëse ato nuk përfshijnë operacione ofensive kibernetike në arsenalin e saj?"[3]

Me sa duket, SHBA mendon se nuk ka asgjë të keqe me këtë qasje mbrojtëse. Në qershor 2015, Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Ashton Carter, deklaroi se "NATO duhet të përmirësojë kapacitetet e saj për të mbrojtur veten nga sulmet kibernetike para se të përpiqet të ndërtojë kapacitetet kibernetike ushtarake të saj."[4]

Carter, natyrisht ka të drejtë kur thotë që nuk do të jetë NATO ajo që ndërton kapacitetet ofensive kibernetike. Kjo nuk ndryshon nga fushat e tjera të luftës ku Aleatët zhvillojnë kapacitete që mund të përdoren në kontekstin e NATO-s. Megjithatë, kjo do të thotë se Aleanca, në pozicionin e saj të përgjithshëm, duhet të vazhdojë të përqendrohet mbi masat mbrojtëse, duke përjashtuar opsionin për të përdorur kapacitetet

---

asdigital-attacks-become-a-standard-part-of-conflict/. Cf. 'Defending the networks, The NATO Policy on Cyber Defence', 2011. http://www.nato.int/nato_static/assets/pdf/pdf_2011_08/20110819_110819- policy-cyberdefence.pdf.

[3] James A. Lewis, 'Offensive Cyber Operations and NATO', Tallinn Paper no. 8, Tallinn 2015, page 2

[4] Lolita C. Baldor, 'Carter: NATO must bolster cyberdefense.' PHYS.org, June 24, 2015, http://phys.org/ news/2015-06-carter-nato-bolster-cyber-defense.html#jCp

ofensive në një operacion të përbashkët. Një sjellje thjesht mbrojtëse nuk ka qenë opsioni i parapëlqyer i komandantëve të suksesshëm ushtarakë. Ashtu siç thotë Clausewitz "forma mbrojtëse në lufta është [...] nuk është një mburojë e dukshme, por një mburojë e formuar nga sulme që ndërmerren me mjeshtëri ".[5]

3. Mbrojtja e rrjetit dhe mbrojtja kolektive

NATO ka përcaktuar dy përgjegjësi të ndryshme që lidhen më mbrojtjen kibernetike: (a) mbrojtja kolektive dhe (b) mbrojtja e rrjeteve të NATO-s. Në vitin 2011, Politika e Mbrojtjes Kibernetike e NATO-s vendosi që me qëllim që të kryhen detyrat kryesore të mbrojtjes kolektive dhe menaxhimit të krizave, duhet të garantohet integriteti dhe funksionimi i vazhdueshëm i sistemeve të saj të informacionit.[6]

Deklarata e Samitit të Uellsit të vitit 2014 e përfshiu këtë, kur Aleanca pranoi se mbrojtja kibernetike është pjesë e detyrës kryesore të mbrojtjes kolektive të NATO-s, por ende Politika për Mbrojtjen Kibernetike e zgjeruar e NATO-s e vitit 2014 nuk arriti të përcaktojë rolet dhe përgjegjësitë.[7] Detyra e mbrojtjes së aleancës kundër sulmeve

[5] Carl Maria von Clausewitz, 'On War', translated by J. J. Graham, Hertfordshire 2013, page 411.

[6] Defending the networks, The NATO Policy on Cyber Defence, 2011. http://www.nato.int/nato_static/ assets/pdf/pdf_2011_08/20110819_110819-policy-cyberdefence.pdf

[7] NATO Wales Summit Declaration, 2014. http://www.nato.int/cps/en/natohq/official_texts_112964.htm; 'Cyber defence', NATO. 16 Feb 2016, http://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_78170.htm.

të armatosura përmes hapësirës kibernetike me mjete ushtarake iu shtua politikës për mbrojtjen e rrjetit.

Për sa kohë që Politika e Mbrojtjes Kibernetike e NATO-s thjesht pranon se parimi i mbrojtjes kolektive është i zbatueshëm në hapësirën kibernetike, duke kufizuar veprimet e mundshme për mbrojtjen e rrjeteve, ajo do të vazhdojë të shkaktojë konfuzion në mesin e aleatëve. Parimi i mbrojtjes kolektive është *raison d'être* e NATO-s dhe parashikohet në qendër të nenit 5 të Traktatit të Uashingtonit. Ai e detyron Aleancën që të mbrojë territorin dhe popullsinë e aleatëve në rast sulmi të armatosur.[8] Si pasojë, përgjegjësia kryesore e Aleancës në hapësirën kibernetike është mbrojtja e aleatëve kundër sulmeve të armatosura nëpërmjet në hapësirës kibernetike, kur është e nevojshme me anë të mjeteve ushtarake.

Megjithatë, i vetmi mjet në dispozicion të saj është mbrojtja e rrjeteve dhe sistemeve të veta. Kjo do të thotë se ndonëse Aleanca e pranon që hapësira kibernetike mund të përdoret nga kundërshtarët për të nisur një sulm të armatosur kundër saj, është e pamundur që Aleanca t'i kundërvihet sulmeve të tilla përmes hapësirës kibernetike. Për NATO-n, kjo është një qasje e re ndaj përgjegjësive të saj. Për shembull do të ishte e paimagjinueshme që në përgjigje të një sulmi të armatosur ajror, NATO nuk do të lejonte përdorimin e fuqisë ajrore, por do ta kufizonte përgjigjen e saj në përdorimin e sistemeve të mbrojtjes ajrore.

[8] Traktati i Atlantikut të Veriut, Neni 5.
http://www.nato.int/cps/en/natolive/official_texts_17120.htm.

Megjithëse, detyrat kryesore të mbrojtjes kolektive dhe mbrojtjes së rrjeteve të veta përmbajnë përgjegjësi të lidhura dhe të mbivendosura qartazi, ato ekzekutohen në kuadër të politikave, ligjeve dhe organizative të ndryshme.

Në parim, përgjegjësia për mbrojtjen e rrjeteve të saj është e njëjtë si për NATO-n ashtu dhe për ndonjë organizatë tjetër të madhe private ose publike që ka informacion sensitiv. Kjo është thelbësore për sigurinë dhe vazhdimësinë e këtyre organizatave, por është një detyrë që kryhet kryesisht në një kontekst kohe paqeje dhe gjatë punës së përditshme. Jashtë kontekstit të një konflikti të armatosur, sulmet kibernetike kundër NATO-s si organizatë do të cilësoheshin si spiunazh kibernetik, krim kibernetik apo, në disa raste, operacione informative; por jo si sulme të armatosura.

Kështu, organizata ka detyrimin të mbrojë rrjetet e saj, sistemet dhe të dhënat, por ekziston një dallim i madh në mes detyrës së ruajtjes së të dhënave dhe veprimeve ushtarake. Po kështu, meqë Aleanca nuk do të përdorë mjete ushtarake për t'u përballur me këto lloje sulmesh kibernetike, politika udhëheqëse në këtë rast nuk duhet të përcaktohet në terminologjinë ushtarake ose të integrohet në një kuadër ushtarak më të gjerë. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se një politikë udhëzuese për përdorimin e operacioneve kibernetike është e panevojshme dhe kjo sigurisht nuk do të thotë se një politikë e mbrojtjes së rrjetit mund të zëvendësojë një politikë për operacionet kibernetike. Në CyCon 2016,

Zëvendës-admirali Arnaud Coustillière, Oficeri i Përgjithshëm francez për Mbrojtjen Kibernetike (Cyberdefence), e shpjegoi punën e tij për publikun si "luftë dixhitale".[9]

Kjo nuk është qartazi dhe kurrë nuk duhet të jetë roli i Komunikimeve të NATO-s dhe Agjencisë Informative (NCIA), i cili është organi i NATO-s përgjegjës për mbrojtjen e rrjetit. Megjithëse NCIA luan një rol të rëndësishëm ushtarak në lidhjen e Aleancës dhe mbrojtjen e rrjeteve të saj në një kuadër operacional, ajo nuk ka kryer operacione kibernetike ofensive. Prandaj, duhet të përcaktohet qartë se ku mbaron roli i NCIA dhe ku fillon Struktura e Komandës së NATO-s.

Duke bërë dallimin ndërmjet mbrojtjes së rrjetit dhe sigurimit të informacionit nga operacionet ushtarake sulmuese kibernetike do t'i jepte mundësinë Aleancës që të qartësonte ndikimin dhe rëndësinë e këtyre çështjeve për NATO-n. Kjo t'i jepte mundësinë Aleancës që të zhvillonte mjete të përshtatshme për reagim ndaj kërcënimeve kibernetike në të gjithë spektrin, duke përfshirë kuadrin e nevojshëm për të mbështetur këto ndryshime, dhe në këtë mënyrë për të përmirësuar efikasitetin e përgjithshëm ushtarak të NATO-s.

[9] Fjalimi Zëvendës-admirali Arnaud Coustillière nw CyCon 2016, Paneli pwr Komandantwt Kibernetikw nw 1 Qershor 2016.

4. NATO dhe operacionet kibernetike

Deri tani, Aleanca nuk ka nxjerrë konkluzionet e duhura nga pranimi se "sulmet kibernetike mund të kërcënojnë prosperitetin, sigurinë, dhe stabilitetin e Aleancës".[10] Koncepti Strategjik i NATO-s së vitit 2010 angazhon Aleancën që të "sigurojë që ajo të ketë gamën e plotë të kapaciteteve të nevojshme për të penguar dhe për t'u mbrojtur nga çdo lloj kërcënimi ndaj sigurisë së popullsive tona".[11]

Gjithashtu, gama e plotë e kapaciteteve në mënyrë eksplicite përfshin "[zhvillimin e mëtejshëm të] kapaciteteve tona për të parandaluar, zbuluar, mbrojtur dhe për ta marrë veten nga sulmet kibernetike."[12] Kjo do të thotë se NATO duhet të jetë në një pozicion për të mbrojtur lirinë dhe sigurinë e Aleatëve kundër kërcënimit nga hapësira kibernetike dhe të jetë në gjendje për t'iu përgjigjur këtyre kërcënimeve në mënyrë të përshtatshme.

NATO duhet të marrë përgjegjësinë për të sjellë politikën e saj të mbrojtjes kibernetike në linjë me Konceptin Strategjik dhe të sigurojë që ajo ka gamën e plotë të kapaciteteve ushtarake të nevojshme për të mbrojtur Aleancën dhe interesat e saj në hapësirën kibernetike. Kjo do të çojë politikën e NATO-s në përputhje me strategjitë dhe politikat e

[10] Koncepti Strategjik i NATO-s, 2010. http://www.nato.int/strategic-concept/pdf/Strat_Concept_web_ en.pdf, para. 12.

[11] Ibid, para. 19

[12] ibid

Aleatëve të shumtë që kanë zhvilluar struktura për përdorimin e kapaciteteve kompjuterike në operacionet ushtarake. Për shembull, Holanda, ka deklaruar se "burimet dixhitale operacionale... përfshijnë elementë mbrojtës, ofensiv dhe të mbledhjes së së inteligjencës." dhe i përkufizon kapacitetet ofensive si "burime dixhitale qëllimi i të cilave është të ndikojnë ose parandalojnë veprimet e një kundërshtari duke u infiltruar në kompjuterët, rrjetet kompjuterike, armët dhe sistemet me sensorë në mënyrë që të ndikojnë në informacionin dhe sistemin."[13] Ambicie të ngjashme po përkthehen nga shumë vende në doktrina të veçanta ushtarake.

SHBA-ja aktualisht ofron pasqyrën më të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të rolit të kapaciteteve kibernetike dhe operacioneve kibernetike në doktrinën ushtarake. SHBA ka zgjedhur një qasje që i sheh kapacitetet kibernetike si kapacitet ushtarak operacional si pjesë e një operacioni ushtarak.[14] Për shembull, sipas Strategjisë Ushtarake Kombëtare për Operacionet Kibernetike të vitit 2006 "Departamenti Amerikan i Mbrojtjes do të përdorë gamën e plotë të operacioneve ushtarake nëpërmjet hapësirës kibernetike për të mposhtur, ndryshuar mendjen dhe të pengojë kërcënimet kundër interesave amerikane."[15]

[13] Përditësojë të Strategjia e Mbrojtjes Kibernetike së Ministrisë Holandeze të Mbrojtjes. Dokumenti parlamentar 33321, nr. 5. Shkurt 2015 faqja 6

[14] Në Strategjinë Kombëtare Ushtarake për Operacionet Kibernetike të vitit 2009, SHBA-ja bën dallimin mes Mbrojtjes së Rrjetit dhe Operacioneve Kibernetike. Strategjia Ushtarake Kombëtare për Operacione Kibernetike e Departamentit të Mbrojtjes të Shteteve të Bashkuara, 2009, faqja 5.

[15] Ibid, faqja 5

Në përputhje me doktrinën e përgjithshme të ushtrisë amerikane, thuhet se "kapacitetet ofensive në hapësirën kibernetike i ofrojnë SHBA-s, si dhe kundërshtarëve tanë një mundësi për të fituar dhe për të ruajtur këtë iniciativë.

Operacionet kibernetike Departamenti i Mbrojtjes janë të forta kur kapacitetet ofensive dhe mbrojtëse janë reciprokisht mbështetëse."[16] Nëse NATO do të vazhdojë të përmbushë rolin e përcaktuar në Konceptin Strategjik, asaj do t'i duhet të kapërcejë hendekun midis strategjive të operacioneve kibernetike kombëtare të aleatëve të ndryshëm dhe politikës së saj në fushën e mbrojtjes kibernetike.

Njohja e hapësirës kibernetike si një fushë do të jetë përbëjë një hap të rëndësishëm në drejtimin e duhur për NATO-n. Kjo do të nxitë aleatët për të përcaktuar jo vetëm termat dhe përkufizimet, por edhe për të ngritur ambiciet e përbashkëta, procedurat, dhe doktrinën.

Thelbi i aktiviteteve të NATO-s ka qenë gjithmonë bashkëpunimi ushtarak mes aleatëve që kryesisht marrin formën e operacioneve të përbashkëta ushtarake dhe fushatave, ose mbrojtjen kolektive të territorit të NATO-s. Procesi i Planifikimit të Mbrojtjes të NATO-s, i projektuar për të siguruar që aleatët kanë mjetet dhe aftësitë e nevojshme për një bashkëpunim të tillë, i mundëson këto aktivitete.[17]

[16] Ibid, faqja 10

[17] Hannes Krause, 'NATO on its way towards a comfort zone in cyber defence', Tallinn paper No.3, Tallinn 2014, page 4

Meqë aleatët po i zhvillojnë kapacitetet operacionale kibernetike, edhe NATO ka nevojë për të filluar planifikimin për përdorimin e tyre të mundshëm në operacionet e përbashkëta ushtarake. Lidhur me vendosjen e mundshme të aftësive sulmuese kibernetike, vendet do të duan të mbajnë kontrollin mbi përdorimin e këtyre mjeteve në nivelin më të lartë në të ardhmen.

Aftësitë kibernetike ende shikohen nga shumica e vendeve si asete strategjike. Pasi këto kapacitete varen kryesisht nga fshehtësia, dhe vendet nuk do të jenë të gatshëm t'ia delegojnë këtë një komandanti në terren. Për shembull, në SHBA, vetëm Presidenti mund të miratojë një operacion kibernetik që ka të ngjarë të rezultojë me "pasoja serioze."[18] Megjithatë, kjo nuk do të thotë se këto aftësi janë të parëndësishme për NATO-n dhe operacionet e drejtuara nga NATO.

Meqë këto kapacitete janë një realitet, Aleanca duhet të planifikojë kontingjentin e vendeve që duan t'i përdorin ato gjatë një operacioni ushtarak të udhëhequr nga NATO. Operacionet ushtarake që kanë të bëjnë me ruajtjen e sekretit ose ndjeshmërinë politike nuk janë të reja për Aleancën. Për shembull, në mënyrë që të zhvillohet një doktrinë kibernetike gjithëpërfshirëse, do të ishte e dobishme të shqyrtohej Doktrina e Përbashkët e Aleatëve të NATO-s për Operacionet Speciale[19].

[18] Lewis, Offensive Cyber, page 8.

[19] Allied Joint Doctrine for Special Operations (AJP-3.5), January 2009. https://www.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/33694/AJP01D.pdf.

Në hyrje të saj, thuhet se operacionet speciale "mund të përshkruhen si veprimtari ushtarake që kryhen nga forca të projektuara, të caktuara, të organizuara, të trajnuara, dhe të pajisura, duke përdorur taktika operative, teknika jo standarde të forcave konvencionale. Konsideratat politiko-ushtarake mund të vihen më pak në dukje, apo të përdoren teknika të fshehta apo diskrete, dhe të pranohet një shkallë rreziku fizik ose politik që nuk lidhet me operacionet konvencionale. "[20] Kjo qasje mund të jetë e krahasueshme me një qasje eventuale për operacione kibernetike. Të paktën, kjo tregon se Aleanca përshtatet dhe është e aftë për zhvillimin e një doktrine pune për kapacitetet duke përdorur "forcat e projektuara posaçërisht që nuk përdorin teknika standarde të forcave konvencionale" dhe "teknika të fshehta apo diskrete".

5. Përfundime dhe rekomandime

Shumë aspekte mbeten të paqarta në lidhje me ndikimin, efektin e mundshëm ose të paparashikuar, kundër-masat e kundërshtarëve, dhe pasojat politike (përshkallëzimi) i përdorimit të kapaciteteve kibernetike ofensive. Kjo pasiguri i bën vendet të hezitojnë në angazhimin me objektivat specifikë dhe ambiciozë të politikave të reja. Gjithsesi kjo mungesë nisme nuk duhet të parandalojë një debat të plotë brenda NATO-s.

[20] Ibid, faqja 1-1

Duke pasur parasysh faktin se disa aleatë kanë deklaruar ambicie për të zhvilluar kapacitetet ofensive kibernetike si pjesë e operacioneve ushtarake, kjo tregon se ka ardhur koha që të ndryshojë politika aktuale e mbrojtjes së kufizuar. Prandaj NATO duhet urgjentisht:

- të njohë hapësirën kibernetike si një fushë për operacionet ushtarake;
- të dallojë mandatin e politikave të zbatueshme për mbrojtjen e rrjetit në kohë paqeje nga mandati i politikave në fuqi për operacione kibernetike në operacionet ushtarake dhe të mbrojtjes kolektive, dhe të nxisë zhvillimin e një politike të re që do t'i mundësojë Aleancës të sigurojë që të ketë gamën e plotë të aftësive të nevojshme për të penguar dhe për t'u mbrojtur prej çdo kërcënimi të hapësirës kibernetike;
- të zhvillojë doktrinën dhe procedurat për të lejuar përdorimin e aftësive kompjuterike si aftësitë operacionale ushtarake.

Sipas mendimit tonë, pavarësisht se NATO ka njohur hapësirën kibernetike si një fushë për operacionet ushtarake, Aleanca do të duhet të marrë një hap vendimtar në Mbrojtjen Kibernetike dhe të lidhë politikën e saj të mbrojtjes kibernetike me sjelljen e përgjithshme, konvencionale dhe strategjike të detajuar në Konceptin Strategjik.

Pra, NATO duhet të investojë në një debat rigoroz dhe transparent për natyrën dhe implikimet e kapaciteteve operacionale kibernetike, si dhe në zhvillimin e politikave, doktrinave, procedurave, dhe një kuadri

ligjor që lejon përdorimin e kapaciteteve kibernetike gjatë misioneve të NATO-s. Edhe në qoftë se hapësira kibernetike rezulton të jetë një tjetër lloj mjedisi për operacionet ushtarake se sa fushat tradicionale, këto diskutime do të ndihmojnë për të siguruar që NATO të ruajë rëndësinë e saj si një aleancë ushtarake lidhur me kërcënimet kibernetike.

Bibliografia

Allied Joint Doctrine for Special Operations (AJP-3.5), Janar 2009. https://www.gov.uk/ government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/33694/ AJP01D.pdf.

Carl Maria von Clausewitz, 'On War', translated by J. J. Graham, Hertfordshire 2013.

David Sanger, 'U.SË. Cyberattacks Target ISIS in a New Line of Combat', The New York Times, Prill 24 2016. http://www.nytimes.com/2016/04/25/us/politics/us-directs-cyberweapons-at-isis-for-first-time. html?_r=0

Defending the networks, The NATO Policy on Cyber Defence, 2011. http://www.nato.int/nato_static/ assets/pdf/pdf_2011_08/20110819_110819-policy-cyberdefence.pdf

Hannes Krause, 'NATO on its way towards a comfort zone in cyber defence', Tallinn paper No.3, Tallinn 2014.

James A. Lewis, 'Offensive Cyber Operations and NATO', Tallinn Paper no. 8, Tallinn 2015.

Lolita C. Baldor, 'Carter: NATO must bolster cyberdefense.' PHYS.org, June 24, 2015, http://phys.org/ news/2015-06-carter-nato-bolster-cyber-defense.html#jCp.

NATO Strategic Concept, 2010. http://www.nato.int/strategic-concept/pdf/Strat_Concept_web_ en.pdf.

NATO Wales Summit Declaration, 2014. http://www.nato.int/cps/en/natohq/official_texts_112964.htm; 'Cyber defence', NATO. 16 Shkurt 2016, http://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_78170.htm.

Steve Ranger, 'NATO updates cyber defence policy as digital attacks become a standard part of conflict'. ZDNet, Qershor 2014. http://www.zdnet.com/article/nato-updates-cyber-defence-policy-asdigital-attacks-become-a-standard-part-of-conflict/. Cf. 'Defending the networks, The NATO Policy on Cyber Defence', 2011. http://www.nato.int/nato_static/assets/pdf/pdf_2011_08/20110819_110819- policy-cyberdefence.pdf.

The North Atlantic Treaty: http://www.nato.int/cps/en/natolive/official_texts_17120.htm.

ENGLISH ABSTRACTS

WHY WILL NATO RESIST AND SURVIVE THE CONTEMPORARY GLOBAL CHALLENGES?

Redion Qirjazi

After the dissolution of the Soviet Union it appeared that NATO had outlived its purpose and thus its reason for existing. However, a quarter of a century after, NATO continues to strive and, on the contrary, showing signs of further expansion. The latest global security challenges have raised concerns that the United States will pivot towards Southeast Asia (particularly China), lose interest in NATO and ultimately cause the Alliance to weaken and gradually unravel.

This paper paints an alternative view of the situation and will argue that regardless of the many geostrategic changes of the recent years, NATO, due to its adaptability and thanks to the vital interest of the US for being in it, will continue to remain a solid Alliance that ill not risk to unravel or weaken in the near future.

PRESSING CHALLENGES: TERRORISM, CYBER SECURITY, PROPAGANDA

Greta Monika Tučkutė and Deividas Šlekys

The crisis in the Middle East and the outbreak of mass migration into Europe, the rise of ISIS (Islamic State), the war in Ukraine and occupation of Crimea, and the terrorist attacks in Paris, Brussels, Istanbul and other cities, have revealed areas of weakness and pose serious challenges to public order, democratic values, fundamental principles and peace in NATO countries and among their neighbors. Russia's attack on Ukraine involved a full range of hybrid measures - "little green men" paramilitary groups, cyberattacks, propaganda, erroneous interpretations of international law, and threats to energy security. The complexity of these dangers and their potential consequences have impelled NATO countries to react at various levels - nationally, multilaterally and collectively. The need for a robust and effective response as emphasized in the ales Summit Declaration in 2014, and resulted in the NATO Readiness Action Plan. The aim of this article is to examine pressing challenges such as terrorism, cyber security and propaganda, as well as the measures used to combat them.

NATO AND ENERGY SECURITY: CURRENT ACHIEVEMENTS AND FUTURE CHALLENGES

Sorin Ducaru

In the second half of 2013 several important steps were taken to firmly anchor energy security on NATO's agenda: to enhance NATO's training and education efforts, the Emerging Security Challenges Division as given the role of Requirements Authority, while the Energy Security Centre of Excellence became Department Head.

At the same time, the Danish-Lithuanian "Green Defense Initiative" raised the visibility of energy efficiency and environmental protection across the Alliance. Did these developments set the stage for a new chapter not only in the cooperation between NATO and the Centre of Excellence, but also for NATO's broader energy security agenda?

THE NATO WARSAW SUMMIT: HOW TO STRENGTHEN ALLIANCE COHESION

Alexander Mattelaer

In July 2016 NATO leaders will meet in Warsaw to formally review whether earlier decisions on strengthening the Alliance's collective defenses are sufficient. Greater efforts will be needed, but consensus may not be easy to achieve.

Below the surface, the cohesion of NATO is under severe strain from multiple crises including Russian revanchism, mass migration, and terrorism. Summit preparations are also taking place under the shadow of potential strategic shocks. Internal disagreements fueled by rising populism could lead to a British exit from the European Union, a disorderly breakdown of the Schengen system, or worse.

In this context, it would be a mistake to underestimate the risk of NATO fragmentation. To strengthen cohesion, US leaders should consider broadening the debate beyond the immediate concerns over Europe's troubled neighborhood, fostering intra-European peer pressure on providing adequate military capabilities, and stimulating European nations to develop complementary force postures. These initiatives could revitalize the transatlantic bond, but would require patient engagement before and after the summit.

IS NATO READY TO CROSS THE RUBICON ON CYBER DEFENSE?

Matthijs Veenendaal; Kadri Kaska; Pascal Brangetto

In April 2016 Robert Work, United States Deputy Secretary of Defense, declared "[we] are dropping cyber bombs" on ISIS. Though rather rhetorically, this statement demonstrates that cyber capabilities are now seen as weapons. Although much remains unclear about the future relevance of cyberspace as a domain for military operations, it is beyond doubt that cyber capabilities can launch attacks that may cause death and destruction.

Given modern armed forces' dependency on digital technology, it is legitimate to expect that NATO would adapt to this new reality. Since 2002, NATO has invested significantly in improving the defense of its networks. However, NATO has shown little inclination to move away from its current purely defensive posture in cyber defense.

At the political level, Allies remain reticent when it comes to discussing the options of using military (offensive) capabilities within a NATO setting. For most of them, cyber operations are generally still uncharted territory in which confusion abounds. Moreover, Allies that have invested heavily in cyber capabilities worry that others might benefit without making a similar investment themselves.

Allies therefore remain reluctant to engage in any meaningful discussion on the position and role of cyber capabilities in military operations within the Alliance.